



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI

**“OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM”**



Dhjetor 2022

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	3
1.1 Konteksti i problemit social.....	3
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
2.4 Pësja në buxhet.....	12
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	14
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	16
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	16
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	16
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	16
3.2 Objektivi i auditimit.....	17
3.3 Pyetjet e auditimit.....	17
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	17
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	18
5. PËRMBLEDHJE	44
6. GRUPI I PUNËS	45
7. ANEKSE.....	46

LISTA E SHKURTIMEVE


3E	Ekonomiciteti, Efienca, Efektiviteti
AFMIS	Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (<i>Albanian Financial Management Information System</i>)
BE	Bashkimi Evropian
ECOSOC	Këshilli për Çështjet Ekonomike dhe Sociale (<i>United Nations Economic and Social Council</i>)
HFLP	Forumi Politik I Nivelit të Lartë mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (<i>High Level Political Forum</i>)
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
IPSIS	Sistemi i Informatik i Planifikimit të Integruar (<i>Integrate Planning Systems information system</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Kryeministria
KN	Komiteti Ndërmnistror
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Plani buxhetor afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (<i>United Nations Economic Commission for Europe</i>)
VNR	Rishikimi Vullnetar Kombëtar për Shqipërinë (<i>Voluntary National Review</i>)
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Edhe pse nuk ka një përcaktim të vetëm, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u paraqit për herë të parë në 1987 në Raportin e Komisionit Botëror në Mjedis dhe Zhvillim të titulluar “Our Common Future” (i njohur ndryshe si Raporti i Brundtland-it). Komisioni e përkufizoi zhvillimin e qëndrueshëm si “zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.”¹ Zhvillimi i qëndrueshëm përfshin integrimin e objektivave sociale, mjedisore dhe ekonomike. Në mënyrë ideale, çdo politikë apo aktivitet njerëzor duhet të sjellë një përmirësim në të tre objektivat. Megjithatë, përparimi në një front mund të arrihet me koston e dëmtimit në një tjetër. Kudo që është e mundur, vendimet duhet të marrin parasysh kostot dhe përfitime të tre shtyllave (sociale, ekonomike e mjedisore). Përkufizimi i Komisionit nxori në pah gjithashtu se brezat e sotëm nuk duhet të arrijnë progres ekonomik në kurriz të prosperitetit të brezave të ardhshëm.² Është e qartë që mjedisi është një nga tre komponentët themelore të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm nuk e trajton mjedisin si një çështje të paprekshme, por pranon se mund të ketë nevojë për një ekuilibër ndërmjet progresit ekonomik, social dhe mjedisor.

Fig.1 Zhvillimi i qëndrueshëm përfshin tre dimensione



Burimi: GUID 5202

¹ GUIDE 5202, paragrafi 1.1.

² GUIDE 5202, paragrafi 1.2.

Arritja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm përfshin integrimin e objektivave ekonomikë, mjedisorë dhe socialë. Ka interpretime të ndryshme të fushës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe peshës që duhet t'i kushtohet shqetësimeve ekonomike, mjedisore dhe sociale. Qeveritë kanë një rol kyç në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ato janë përgjegjëse për përcaktimin e drejtimit, bërjen e politikave dhe sigurimin e koordinimit. Ato përfaqësojnë interesat e kombit në negociata ndërkombëtare dhe angazhohen për shembull për përgatitjen e politikave/programeve kombëtare për të promovuar dhe nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.³

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm demonstrojnë nivelin dhe ambicien e Axhendës 2030 duke kërkuar të drejta të barabarta për të gjithë, fuqizuar e grave dhe vajzave si dhe integruar në mënyrë të pandashme një balancë midis tre dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm, atij ekonomik, social dhe mjedisor.⁴

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përbëhen nga 169 *targets* ose synime dhe 231⁵ indikatorë⁶. Korniza globale e indikatorëve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm u zhvillua nga Grupi i Ekspertëve dhe Ndër-Agjencive për Indikatorët e OZHQ (*Inter-Agency and Expert Group on SDG Indicators- IAEG-SDGs*) dhe u ra dakord në sesionin e 48-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara të mbajtur në mars 2017. Korniza globale e treguesve u miratua më vonë nga Asambleja e Përgjithshme më 6 korrik 2017 dhe përfshihet në Rezolutën e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për Punën e Komisionit Statistikor në lidhje me Axhendën 2030, për Zhvillim të Qëndrueshëm (A/RES/71/313). Sipas Rezolutës, korniza e treguesve do të përpunohet çdo vit dhe do të rishikohet në mënyrë gjithë përfshirëse nga Komisioni i Statistikave. Kuadri global i treguesve do të plotësohet me tregues në nivel rajonal dhe kombëtar, të cilat do të zhvillohen nga Shtetet Anëtare.⁷ Pra, e thënë më qartë, të gjitha shtetet të cilat janë zotuar vullnetarisht të zbatojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm duhet të hartojnë indikatorët në kontekstin kombëtar të tyre.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Një ndër dokumentet kryesore që do të përdoret si udhërrëfyes në këtë auditim është edhe GUID 5202 i cili mbështetet dhe bazohet në ISSAI 5130 “Zhvillimi i Qëndrueshëm: Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit”. Këto dokumente (veçanërisht GUID 5202) përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance dhe në rastin konkret edhe këtë auditim i cili për nga natyra e tij paraqitet mjaft kompleks dhe i veçantë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike apo*

³ GUIDE 5202, paragrafi 1.9.

⁴ TRANSFORMING OUR WORLD: THE 2030 AGENDA FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT, fq 5

⁵ Shënim: meqenëse disa prej tyre përsëriten në disa OZHQ dhe synime, numri i tyre shkon në 248 tregues

⁶ https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Framework%20after%202022%20refinement_Eng.pdf

⁷ <https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/>

*fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni*⁸, etj., por dhe në kërkesat e vazhdueshme të organizmave ndërkombëtare dhe së fundmi edhe të Kuvendit të Shqipërisë, KLSH ndërmori auditimin me temë “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me përgatitjen dhe koordinimin nga qeveria shqiptare për të bërë të mundur arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur. Auditimet e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të ndjekin të gjitha standardet e zakonshme të ndjekura nga SAI, për shembull ato të vendosura nga INTOSAI dhe çdo standard kombëtar. Edhe pse zhvillimi i qëndrueshëm mund të jetë një temë më kompleks se shumë tema të tjera të auditimit, kjo nuk do të thotë se standardet për planifikimin, mbledhjen e evidencave, analizimin dhe raportimin të jenë më të relaksuara se në auditimet e tjera të performancës. Zhvillimi i qëndrueshëm është i rëndësishëm për SAI-t sepse është i rëndësishëm për organet që ato auditojnë. Roli kushtetues dhe mandatet e shumicës së SAI-ve ashtu si edhe KLSH nuk i lejojnë ato të bëjnë politika por vetëm të auditojnë zbatimin e tyre.⁹

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Duhet theksuar se Departamenti i Auditimit të Performancës nuk ka zhvilluar deri më sot ndonjë auditim i cili të fokusohet drejtpërsëdrejti në arritjen dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ky është auditimi i parë i cili synon të hulumtojë dhe të pasqyrojë gjendjen e vendit tonë sa i përket monitorimit, zbatimit dhe raportimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Kryeministria;
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kryeministria. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁰, Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministrat. Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore. Kryeministri përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij, koncepton dhe paraqet drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to si dhe siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Referuar ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave”¹¹, Kryeministri, përveç kompetencave të parashikuara në Kushtetute dhe në ligje të veçanta, ushtron edhe këto kompetenca: përfaqëson dhe drejton Kryeministrinë; u kërkon ministrave përgjegjës shpjegime, relatime dhe verifikime administrative, për çështje të fushës që ata mbulojnë; pezullon zbatimin e akteve të ministrave, të drejtuesve të institucioneve qendrore, në varësi të tij ose të ministrave, me njësinë e vet ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, kur konstaton shkelje të Kushtetutës, të ligjeve, ose të akteve të Këshillit të Ministrave. Me miratimin e Këshillit të Ministrave, Kryeministri mund të marrë përsipër edhe detyra të tjera. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrave të Shtetit me seli në Tiranë.

⁸ Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

⁹ GUIDE 5202, paragrafi 1.13

¹⁰ <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf>

¹¹ Ligji nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave”

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Ajo përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë, të strehimit dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Kjo ministri harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

- Politikën makroekonomike dhe fiskale;
- Administrimin e të ardhurave;
- Administrimin e buxhetit të shtetit;
- Menaxhimin e borxhit publik;
- Administrimin financiar;
- Menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;
- Inspektimin financiar publik;
- Bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
- Fushën e strehimit;
- Fushën e punësimit;
- Fushën e arsimit dhe formimit profesional;
- Fushën e sigurimeve shoqërore;
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë;
- Nxitjen e investimeve;
- Ndihmën shtetërore dhe garancitë shtetërore.¹²

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.¹³ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- a) Zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- b) Zhvillimin e monitorimin e politikave të legjislacionit, të programeve dhe të veprimtarive, që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e me treguesit shëndetësorë të popullatës;
- c) Zhvillimin e strategjive dhe të politikave që synojnë përmirësimin gradual të performancës së të gjithë ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet sistemit të akreditimit;
- ç) Zhvillimin e politikave dhe të programeve kombëtare, që synojnë mbrojtjen e promovimin e shëndetit, si dhe parandalimin, diagnostikimin e trajtimin e sëmundjeve në popullatë;
- d) Hartimin e përditësimin e të gjitha protokolleve të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore;
- dh) Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin e përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, të familjeve dhe të komuniteteve në nevojë;

¹² <https://financa.gov.al/misioni/>

¹³ <https://shendetesia.gov.al/misioni-2/>

- e) Zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, të abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mos diskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnisë dhe minoritetit;
- ë) Zhvillimin e politikave dhe të modeleve për ndihmën e shërbimet shoqërore alternative për individët e grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike;
- f) Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale;
- g) Marrjen e masave e ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare, të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.¹⁴

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha të përgjegjësisë shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

- a) Sektorin e Mjedisit, përfshirë politikat, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis.
- b) Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura.
- c) Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave.
- d) Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.¹⁵

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rezoluta “A/RES/70/1- *Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development*” u miratua nga 193 shtete anëtare të OKB-së, përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në Samitin e shtatorit 2015 për Zhvillim të Qëndrueshëm;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, miratuar me VKM nr.348, dt.11.5.2016, në kapitullin përkatës për mekanizmat zbatuese të SKZHI 2015-2020, dhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale të miratuara me VKM, përgjatë viteve 2015-2020 (ku strategjitë sektoriale kanë edhe impakt në buxhetimin e fondeve në PBA, përmes Planeve të veprimit të tyre të buxhetuara në mënyrë indikative);
- VKM Nr.248, datë 24.4.2019, për Fondin e Përsheptimit të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm – *SDG Acceleration Fund*);
- Urdhri i Kryeministrit, Nr.183, datë 23.6.2014 “Për përgatitjen e dhe hartimin e SKZHI 2014-2020”;

¹⁴ Rregullore e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

¹⁵ Rregullore e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”

- Urdhëri i Kryeministrit nr.63, datë 12.5.2017, “Për ngritjen e Komitetit ndërmnisror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm”, (ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.249, datë 12.12.2017);
- Urdhëri i Kryeministrit nr.70, datë 22.05.2017 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”;
- Urdhëri i Kryeministrit nr.248, datë 28.12.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.70, datë 22.05.2017“Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”;
- Udhëzimet standarde për përgatitjen e buxhetit, (përfshirë edhe Udhëzimin për Buxhetimin Gjinor, si aspekt i kuadrit OZHQ);
- “Raporti mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese, për Shqipërinë”, Janar 2018, i përgatitur nga ekspertit kombëtar Ilir Ciko në bashkëpunim me Politikën e Zhvillimit dhe Qeverisjes së Mirë në Departamentin e Zhvillimit dhe Qeverisjes së Mirë, Këshillin e Ministrave, Agjencinë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, INSTATI, Ministrinë dhe të gjithë institucionet kombëtare pjesëmarrëse në implementimin e Axfordës 2030;
- Urdhëri i Kryeministrit. Nr.157, datë 30.12.2021, në përputhje me VKM nr.642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.

Në shtator 2015, në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Qeveria e Shqipërisë, së bashku me 192 vendet anëtare të OKB-së, është angazhuar për zbatimin e Axfordës 2015-2030 për zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet miratimit të deklaratës së përbashkët.

Rezoluta “A/RES/70/1- Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development” (Rezoluta “A/RES/70/1-Të Transformojmë Botën Tonë), u miratua nga 193 shtete anëtare të OKB-së, përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në Samitin e shtatorit 2015 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Në aspektin politik e juridik, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme kanë vlerë rekomanduese (sipas UN Charter) Grafiku UN për vendet anëtare dhe ligjërisht nuk bëhen pjesë e ligjit të brendshëm (sikurse karta parashikon në rastin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB). Kjo rezolutë nuk është miratuar më pas me ndonjë akt ligjor të Qeverisë Shqiptare, siç edhe konfirmuar me MEPJ-në. Në përputhje me përmbajtjen e Rezolutës “A/RES/70/1- Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development” (Rezoluta “A/RES/70/1-Të Transformojmë Botën Tonë), procesi i zbatimit të Axfordës 2030 dhe arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG), është në baza vullnetare për shtetet nënshkruese.

Kjo shprehet në pika të veçanta të Rezolutës, që theksojnë karakterin e lirë të zbatimit të saj nga vendet anëtare të OKB-së, si .sh pika 5, pika 18, pika 72, pika 84, etj.¹⁶ Në zbatim të Axfordës 2015-2030 të OKB-së, për zhvillim të qëndrueshëm, Kryeministri i Shqipërisë ka nxjerrë:

Urdhërin nr.63, datë 12.5.2017 “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnisror për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, i cili është ndryshuar me Urdhërin Nr.249, datë 28.12.2017 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.63, datë 12.5.2017, të Kryeministrit, “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnisror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm”, Urdhërin nr.70, datë 22.05.2017 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”; ndryshuar me Urdhrin nr.248, datë 28.12.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.70, datë 22.05.2017 “Për ngritjen e grupit

¹⁶https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/generalassembly/docs/globalcompact/A_RES_70_1_E.pdf

ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”;

Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), aktualisht është struktura më e lartë qeveritare, e cila monitoron zbatimin e dokumentave strategjikë, planifikimi i të cilave është integruar dhe në përputhje me detyrimet e vendit në kuadër të axhendës së Integritimit Evropian dhe Axhendës 2030 së Kombeve të Bashkuara;

Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit (SPU), pjesë e Departamentit të Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj (DZHNH), në Kryeministri, në rolin e saj të Sekretariatit të Përgjithshëm të KPS/KKI është struktura qendrore e koordinimit të politikave edhe në drejtim të procesit të zbatimit të OZHQ-ve¹⁷.

Procesi i arritjes së OZHQ-ve globale, në kuadrin e miratimit të Axhendës së vitit 2030 është në baza vullnetare¹⁸. Qeveria Shqiptare ka ndjekur qasjen për integrimin në sistemet dhe instrumentet kombëtarë të proceseve dhe të Axhendës 2030, specifikuar si më poshtë:

- Inkorporimi/integrimi i procesit për objektivat globale të Axhendës globale 2030 - arritja e OZHQ-ve - në Sistemin Kombëtar të planifikimit të Integruar (SPI-në).
 - o Kjo nënkupton përfshirjen e Axhendës globale 2030 në proceset e planifikimit strategjik kombëtar përmes instrumenteve dhe mekanizmave të SPI-së, si SKZHI, PBA, mekanizmi GMIP-ve etj.
- Përthyerja dhe harmonizimi i OZHQ-ve me kuadrin strategjik të vendit, pra Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI 2020) dhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale të miratuara me VKM, përgjatë viteve 2015-2020 (ku strategjitë sektoriale kanë edhe impakt në buxhetimin e fondeve në PBA, përmes Planeve të veprimit të tyre të buxhetuara në mënyrë indikative).

Në këtë kuadër, OZHQ-të janë përthyer në kuadrin strategjik të vendit, në SKZHI 2020 dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale, të cilat kanë plane veprimi me buxhete indikative, që më pas inkorporohen/ buxhetohen përmes PBA-së (sipas akteve ligjore respektive përgatitjen e programit buxhetit afatmesëm) dhe ndjekja e zbatimit vijon duke përdorur mekanizmin e Qasjes Sektoriale të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave.

Kjo qasje është ndjekur me qëllim eficiencën lidhur me: (i) përdorimin e mekanizmave të sistemeve të vendit; (ii) evitimin e mbivendosjeve të proceseve planifikuese/dokumenteve strategjikë planifikues; (iii) përdorimin efektiv të burimeve njerëzore; (iii) planifikimin realist të burimeve në kuadër të Axhendës 2030, si pjesë e axhendës zhvillimore të vendit; (iv) evitimin e raportimeve të dyfishta në kuadër të ndjekjes së zbatimit.

OZHQ-të konsiderohen që përplotësojnë qëllimet strategjike të vendit lidhur me integrimin evropian dhe zhvillimin kombëtar, sikundër përcaktohen në SKZHI 2020. Shtojca 3 e SKZHI 2015-2020 paraqet përthyerjen pra lidhjen midis OZHQ-ve me komponentët kryesorë të SKZHI 2015-2020 (sipas kapitujve dhe seksioneve të SKZHI).

Në dokumentet strategjike të ministrive të linjës (strategjitë sektoriale), vijon edhe përthyerja e OZHQ-ve dhe harmonizimi i tyre në objektivat sektoriale dhe në planet e tyre të veprimit (PV të strategjive sektoriale/ndërsektoriale), ku planifikohen në mënyrë indikative buxhete për realizimin e objektivave dhe masave. Buxhetimi i strategjive sektoriale e ndërsektoriale vijon përmes ciklit të buxhetimit dhe PBA-së, ku vetë institucionet, sipas fushave të përgjegjësisë së tyre, sigurojnë lidhjen midis objektivave/masave të tyre të miratuara në strategjitë sektoriale dhe të harmonizuara me OZHQ-të. Në Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave diskutohen raporte monitorimi të përgatitura për strategjitë sektoriale ose drafte dokumentesh strategjikë para miratimit me VKM. Qeveria Shqiptare tashmë e konsideron kornizën e OZHQ-ve si një element të rëndësishëm të vizionit

¹⁷ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

¹⁸ Në Shtator 2015, Republika e Shqipërisë, së bashku me 192 anëtarë të tjerë të KB, u angazhuan për zbatimin e Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke miratuar Deklaratën e Samitit për Zhvillim të Qëndrueshëm, të mbajtur në NYC.

për kuadrin strategjik të vendit, konkretisht për vizionin e draft Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (në proces hartimi) dhe për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të vendit.

Në lidhje me masat e marra nga Komiteti Ndërmintor për Arritjen e OZHQ-ve, janë gjeneruar:

1. diskutimi nga Komiteti në mbledhjen e tij të parë, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për arritjen e OZHQ-ve, për forcimit të instrumentave financiarë për zbatimin e OZHQ-ve. Diskutimi dhe orientimi i Komitetit lidhet me modifikimin e fondit të Kohezionit Social të UN në Fondin për OZHQ-të, në mënyrë që të përfshihen dhe partnerë të tjerë zhvillimi, me qëllim sigurimin e asistencës lidhur me OZHQ-të (duke rezultuar më tej me miratimin e VKM Nr.248, datë 24.4.2019, për Fondin e Përsheptimit të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm – *SDG Acceleration Fund*).
2. diskutimi mbi arritjet mbi OZHQ-të dhe nxitjen e masave për aspekte specifike të zbatimit, në të 3 mbledhjet e zhvilluara nga Komiteti,
3. diskutimi dhe miratimi, në mbledhjen e dytë të Komitetit në janar 2018, i dokumentit “Raporti mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese, për Shqipërinë”, i cili përmban rekomandime specifike për masat për çdo OZHQ dhe treguesit.

Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) përbën një bashkësi parimesh operative për të siguruar që planifikimi dhe zbatimi i politikave planifikuese të qeverisë të bëhet në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. SPI-ja përfshin dy shtylla bazë për planifikimin strategjik dhe bashkërendimin e politikave në nivel kombëtar:

- Procesi i planifikimit strategjik afatmesëm deri në afatgjatë të SKZHI II¹⁹, shoqëruar me strategji sektoriale, të cilat udhëheqin politikë-bërjen në nivel të lartë në përcaktimin e përparësive dhe qëllimeve strategjike kombëtare, dhe,
- Procesi i buxhetimit afatmesëm, ose programi buxhetor afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri dhe agjenci qeveritare të përgatisë një plan tre vjeçar brenda një tavani të përcaktuar shpenzimesh, për realizimin e objektivave të politikave, si hapa të ndërmjetme për përmbushjen e SKZHI-II.

Sa më sipër citohet edhe në dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, miratuar me VKM nr.348, dt.11.5.2016, në kapitullin përkatës për mekanizmat zbatuese të SKZHI 2015-2020.

“*Voluntary National Review for Albania*” ose ndryshe Rishikimi Kombëtar Vullnetar i Arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Shqipëria, është një dokument i rëndësishëm që thekson progresin që ka bërë Shqipëria në implementimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për periudhën 2015-2017. Ky raport, përgatitja e të cilit zgjati deri në qershor 2018, pasqyron momentin e reflektimit nga Qeveria Shqiptare të shkallës së arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Vizioni i Qeverisë Shqiptare referuar këtij raporti vullnetar për OZHQ-të është të sigurojë një demokraci të fortë drejt integrimit evropian. Synimi për të mos lënë askënd mbrapa është qëllimi kryesor i Axhendës 2030. Shqipëria ka përqafuar anëtarësimin global për arritjen e OZHQ-ve të dizenuara për të zbatuar axhendën 2030, në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim (NSDI) dhe procesin e integrimit evropian. Në figurën nr. 3 më poshtë paraqitet përgjegjësia e institucioneve për zbatimin e OZHQ në cilat pasqyrohet edhe numri i *targets* (synimeve) të cilat duhet të mbahen në konsideratë në këto institucione.²⁰ Në këtë tabelë është përcaktuar edhe numri i *targets* (synimeve) për subjektet nën auditim, respektivisht 43 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, 38 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 30 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁹ SKZHI-II është dokument sintezë e strategjive sektoriale e ndërsektoriale, si edhe dokumenteve të tjera planifikuese për reformat, të hartuara deri në fund të vitit 2015, të cilat janë miratuar kryesisht me Vendim të Këshillit të Ministrave.

²⁰ Voluntary National Review on SDG for Albania, fq 30.

Fig.2 Përgjegjësia e institucioneve sipas synimeve të OZHQ

Government Institution	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	Number of SDG targets per institution
Ministry of Health and Social Protection																		38
Ministry of Finance and Economy																		43
Ministry of Infrastructure and Energy																		23
Ministry of Tourism and Environment																		30
Ministry of Agriculture and Rural Development																		11
Ministry of Education, Sports and Youth																		11
Ministry of Interior																		8
Ministry of Justice																		3
Civil Emergencies Department (Ministry of Defense)																		2
Bank of Albania																		3
Technical Secretariat, National Committee of Water																		5
e-Authority																		2
INSTAT																		2
Ministry of Culture																		1
Ministry for Europe and Foreign Affairs																		1
Civil Society Support Agency																		1
National Agency for Scientific Research and Innovation																		4
Public Procurement Agency																		1

Burimi: VNR fq 30

“Raporti mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese, për Shqipërinë”, i miratuar në janar 2018 nga Komiteti Ndërmintor analizon gjendjen ose gatishmërinë e Shqipërisë për të zbatuar OZHQ duke marrë në konsideratë kornizën strategjike dhe institucionale të vendit si dhe gjithashtu miratoi çështjet kryesore që do të përmbante Raportimi Kombëtar Vullnetar, përgatitja e të cilit zgjati deri në qershor 2018. Në këtë raport përveç se përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e targets (njësoj siç është bërë te *Voluntary National Review on SDG*) është vlerësuar niveli i përafrimit ose i ndërlidhjes midis targets të OZHQ me kornizën e politikave kombëtare sektoriale. Mesatarisht, niveli i përafrimit të targets me politikat kombëtare është në nivelin 62 %.²¹ Për të ndjekur progresin mbi zbatimin e OZHQ, Grupi i Ekspertëve dhe Ndër-Agjencive për Indikatorët e OZHQ ka rënë dakord dhe ka propozuar një kuadër global tregues që vendet mund të zgjedhin ta miratojnë për nevojat e tyre.

2.4 Pesha në buxhet

Ndjekja, monitorimi dhe raportimi i progresit për OZHQ realizohet nëpërmjet financimit buxhetor të strukturave dhe/ose financimit të projekteve specifike për këtë qëllim.

Referuar raporteve të zbatimit faktik të buxhetit për vitet nën auditim u audituan PBA respektive dhe institucionet nën auditim, kanë planifikuar dhe realizuar shpenzimet e përgjithshme sipas pasqyrës në vijim.

Tab. 1 Buxheti i planifikuar dhe realizuar për Institucionet nën auditim në 000/lekë

INSTITUCIONET	Kryeministria	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PERIUDHA AUDITUAR				
V. 2018 Buxheti fillestar	960,000	2,258,760	60,116,852	60,868,921
V. 2018 Buxheti i rishikuar	1,138,254	2,284,761	59,106,690	58,930,700
V. 2018 Realizimi faktik	593,430	2,221,833	58,444,203	57,529,009
V. 2017 Realizimi faktik	1,221,706	3,770,000	57,373,940	61,571,423
V. 2019 Buxheti fillestar	1,000,000	2,637,880	59,564,277	58,031,139

²¹ Raporti mbi harmonizimin e OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese, për Shqipërinë, fq 29.

V. 2019 Buxheti i rishikuar	1,014,985	2,732,490	44,490,292	58,011,514
V. 2019 Realizimi faktik	605,903	2,645,741	44,128,994	56,636,375
V. 2018 Realizimi faktik	593,430	2,221,833	58,444,203	57,529,009
V. 2020 Buxheti fillestar	591,000	2,241,030	62,969,940	59,857,139
V. 2020 Buxheti i rishikuar	586,160	2,719,929	69,165,856	83,557,353
V. 2020 Realizimi faktik	467,583	2,747,867	67,811,411	81,606,685
V. 2019 Realizimi faktik	605,903	2,645,741	44,128,994	56,636,375
V. 2021 Buxheti fillestar	728,000	2,268,030	71,452,605	68,476,838
V. 2021 Buxheti i rishikuar	1,164,912	2,552,130	79,683,382	71,454,403
V. 2021 Realizimi faktik	1,143,323	2,516,342	78,361,204	69,715,039
V. 2020 Realizimi faktik	467,583	2,747,867	67,811,411	81,606,685

Burimi: <https://financa.gov.al/buxheti-faktik-nder-vite>

Gjatë fazës studimore grupi i auditimit adresoi kërkesat nëpërmjet takimeve dhe nëpërmjet një pyetësori ku ndër të tjera nëse në planifikimet buxhetore për periudhën nën auditim janë parashikuar fonde buxhetore të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve dhe funksionimin e tyre në drejtim të ndjekjes, monitorimit dhe raportimit të progresit të OZHQ. Nga komunikimi, përgjigjet e pjesshme të pyetësorëve dhe auditimit të PBA respektive 2018-2021 nuk erdhi në vëmendje të audituesve parashikim buxhetor për kapacitete në drejtim të ndjekjes dhe monitorimit të shkallës së arritjes së OZHQ madje as referencë për përshtatshmëri apo pritshmëri ndikimi të objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në buxhetet respektive me OZHQ.

*Shqipëria mori statusin e vendit kandidatit për në BE në qershor të vitit 2014. Në shtator të vitit 2015, Shqipëria miratoi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), së bashku me të gjitha shtetet e tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara. Në fillim të vitit 2016, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Evropian) (SKZHI II) për periudhën 2015- 2020.*²²

Duke konsideruar si themel sa cituar më sipër, KM nënshkroi më 24 Tetor 2016 angazhimin për vënien në jetë të Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet KM të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, të përfaqësuara nga Koordinator i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara dhe Skuadra e kombeve të Bashkuara e përbërë nga UNDP, UNICEF, UN Women, UNFPA, UNHCR, OBSH, FAO dhe IOM. “Ky Program Bashkëpunimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (PBZhQ) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara përbën një kuadër që do të shërbejë si udhërrëfyes për punën e Këshillit të Ministrave, të skuadrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (UNCT) dhe partneritetet e tyre deri në vitin 2021.... Duke marrë parasysh arkitekturën në ndryshim të asistencës për zhvillim në nivelin global, do të kërkohej mekanizma novatorë për financimin e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm mbështetur në partneritete të ndryshme përfshirë dhe partneritetin me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë”.²³

Mbështetur në PBZhQ, zbatimi i plotë i tij “do të kërkojë një total të llogaritur prej 108,918,481 dollarësh amerikan. Kjo përfshin 15,340,000 dollarë amerikan nga burimet e rregullta, ose bazë, dhe 22,587,481 dollarë amerikan nga burime të tjera, ose jo bazë. Hendeku i përgjithshëm i llogaritur është 70,991,000 dollarë amerikan. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesë përpjekjet e agjencive të sistemit të OKB-së për të mbledhur fondet e nevojshme për zbatimin e këtij PBZhQ-je. Si vend me të ardhura të mesme, pritet që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë të nxisë investimet e partnerëve duke ofruar burimet e veta katalitike në PBZhQ. QSh-ja dhe agjencitë e sistemit të Kombeve të Bashkuara do të hartojnë një strategji të përbashkët të mobilizimit të burimeve, për të trajtuar hendekun në financim. Strategjia do të përfshijë

²² Programi i Bashkëpunimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, fq 8.

²³ Programi i Bashkëpunimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, fq 1-3.

nismat individuale dhe të përbashkëta të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara. Ajo do të përcaktojë përgjegjësitë dhe parimet drejtuese, mekanizmat për mbledhjen e fondeve, treguesit dhe rregullat e raportimit”.²⁴

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

“Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (OZHQ) bazohen në plotësimin e të drejtave të njeriut, në arritjen e barazisë gjinore dhe në fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave në shoqëri. Ato përfshijnë në mënyrë të pandashme dhe të ekuilibruar tre dimensionet e Zhvillimit të Qëndrueshëm: dimensionin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor. OZHQ-të vendosin konturet e botës që duam dhe me të vërtetë nevojën e një botë pa varfëri dhe pa privim; një botë më e drejtë; një botë që respekton kufijtë natyrorë. Ato përfaqësojnë ndërlidhjen **“5P” të prosperitetit, njerëzve, planetit, partneriteteve dhe paqes**. OZHQ-të janë përgjigja e duhur ndaj sfidave të mëdha të shekullit të 21-të, antidoti i duhur për humbjen e besimit në institucionet e të gjitha llojeve dhe, në disa vende, humbja e besimit në bashkëpunimin global. OZHQ-të janë pjesë e Agjendës 2030, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015 me Rezolutën “70/1. Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm” dhe synohen të arrihen deri në vitin 2030”.²⁵

“Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim” (SKZHI) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon axhendën e integritetit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. SKZHI II është dokumenti që paraqet vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2015-2020, duke ravigjzuar aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian.

“Voluntary National Review” (VNR) Rishikimi Vullnetar Kombëtar për Shqipërinë është një dokument i rëndësishëm që nxjerr në pah progresin që Shqipëria ka bërë në zbatimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Objektivat për periudhën 2015–2017.

“Komiteti Ndërministror” (KN) Komiteti Ndërministror për OZHQ-të mbështetet nga aktiviteti i Grupit Ndërinstitucional të punës për OZHQ-të, i cili përfshin përfaqësues të nivelit teknik nga të gjitha institucionet shqiptare që marrin pjesë në zbatimin e Axhendës 2030.

“Plani buxhetor afatmesëm” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni, që pritet të kryhet në një periudhë trevjeçare.

“Plani buxhetor njëvjeçar” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni, që pritet të kryhet në një periudhë njëvjeçare.

“Grupi i Planifikimit dhe Menaxhimit të Integruar” (GPMI) janë struktura menaxhuese për të siguruar bashkërendim efektiv dhe përdorim efikas të burimeve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara.

“Programi i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm” (PBZHQ) 2017-2021 Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (PBZhQ) 2017-2021 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara përbën një kornizë për arritjen e rezultateve, përqendrohet tek mbështetja për të ecur përpara, dhe është një program strategjik, largpamës dhe plotësisht në përputhje me përparësitë strategjike të vendit.

“Grupet e Rezultateve” (GR) janë mekanizma që synojnë të kontribuojnë për rezultate specifike të PBZhQ-së, përmes planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Ato përcaktohen në fazën e planifikimit strategjik dhe harmonizohen me matricën e rezultateve të PBZHQ-ve.

“Komiteti i Përbashkët Ekzekutiv” Komiteti i Përbashkët Ekzekutiv ofron orientim strategjik dhe mbikëqyrje lidhur me programin. KPE-ja kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe Koordinatori i Përhershëm i OKB-së në vend. KPE-ja mbledhet njëherë në vit, me pjesëmarrjen e ministrave, Zyrës së Kryeministrit dhe pjesëtarëve të Skuadrës Vendore të OKB-së dhe i raporton Komitetit të Planifikimit Strategjik të QSh-së.

²⁴ Programi i Bashkëpunimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, Kapitulli 3, fq 39.


²⁵ <https://shtetiweb.org/2018/09/19/synimet-e-zhvillimit-te-qendrueshem/>

“Grupet e Punës për Produktet” (GPP) janë një mekanizëm kyç në mbështetje të punës të Grupeve të Rezultateve. GPP-të janë komitete teknike, që përbëhen nga përfaqësues të Partnerëve Zbatues, përfshi partnerë nga shoqëria civile dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për arritjen e një ose më shumë produkteve specifike, që kontribuojnë në rezultatet e PBZhQ-së. GPP-të janë të organizuara rreth produkteve të përcaktuara në PPP-të e njëpasnjëshme që lidhen me Rezultatet. GPP-ja kryesohet nga ekspertë teknikë prej Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara.

“Skuadra e Menaxhimit të Operacioneve” (SMO) ofron mbështetje dhe këshillim për SKB-në, lidhur me përpjekjet për harmonizimin e veprimtarive të punës dhe kontribuon për realizimin e rezultateve të PBZhQ-së. SMO-ja do të sigurojë ofrimin e shërbimeve të përbashkëta më cilësore, efektive dhe me kosto efikase në prokurime, burimet njerëzore, TIK, financë, logjistikë dhe transport. SMO-ja kryesohet nga Drejtori/ ja i/e Agjencisë, sipas rastit dhe përbëhet nga Zyrtari më i lartë Operativ ose Administrativ i secilës Agjenci të Kombeve të Bashkuara.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input – Output



2.7 Feedbacku i subjektit

Gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit, stafet përgjegjëse të KM, MTM, MFE, MSHMS i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre, kjo edhe për shkak të kompleksitetit të çështjes nën auditim por më kryesorja ishte problemi i internetit nga sulmet kibernetike që ndodhën në muajin korrik.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weakness, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Tab. 2 Analiza SWOT


	Fuqitë	Dobësitë
Faktorë të brendshëm	-Miratimi nga QSH i (OZHQ-të), shtator 2015. -Miratimi nga QSH i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Evropian) (SKZHI II) për periudhën 2015- 2020. -Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (PBZhQ) 2017-2021 ndërmjet KM të RSh dhe Kombeve të Bashkuara. -Programi i mëparshëm i bashkëpunimit, dhe vazhdimi qasjes “Një OKB” -KM i RSh të nxisë investimet e partnerëve duke ofruar burimet e veta katalitike në PBZhQ. -Grupet e Punës për rezultatet dhe produktet.	-Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive dhe strukturave të vartësisë. -Kapacitetet e kufizuara institucionale dhe profesionale. -Niveli i lartë i lëvizjeve të stafit dhe mënyrat e fragmentuara të ofrimit të shërbimeve me ndikim mbi shpejtësinë në të cilën zbatohet marrëveshja dhe PBZhQ. -Kudër më i fortë monitorimi të rezultateve, me lidhje të qarta dhe kontribuese për prioritetet dhe indikatorët e SKZHI II-it dhe për kuadrin e indikatorëve për OzhM. -Mungesa e GPR dhe GPP. -Cilësia e dobët dhe disponueshmëria e pamjaftueshme e të dhënave. -Lidhjet e pamjaftueshme midis përparësive të SKZHI-së dhe OZhQ-ve. -Mungesë financimi buxhetor për kapacitetet monitoruese. -Angazhim i pamjaftueshëm midis Sekretariateve të GPMI-së dhe strukturës menaxhuese të PBZhQ-së, për të siguruar bashkërendim efektiv dhe përdorim efikas të burimeve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara.
	Mundësitë	Kërcënimet
	-Statusi i vendit kandidat për në BE, qershor 2014. -Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (PBZhQ) 2017-2021 ndërmjet KM të RSh dhe Kombeve të Bashkuara. -Gama e plotë e ekspertizës dhe burimeve të agjencive të sistemit të	-Kapacitete humane të mangëta një subjektet përgjegjëse për monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e OZHQ. -Koherencë e pamjaftueshme e politikave sektoriale kombëtare dhe OZHQ. -Përdorimi jo efektiv i vlerësimeve të strukturuar të kapaciteteve për të siguruar që rezultatet dhe ndërhyrjet për zhvillim kapacitetesh janë të targetuara drejt dhe në mbështetje të ministrive dhe departamenteve sektoriale në nivelet kombëtare dhe lokale.

Faktorë të jashtëm	OKB-së, sigurimi i partneritetit për të arritur rezultatet e zhvillimit (PSO-të). -Kombet e Bashkuara do të punojnë së bashku për përmbushjen e angazhimeve, duke përfshirë edhe koordinimin e përbashkët, marrëveshjet e zbatimit, partneritetet, mobilizimin e burimeve të përbashkëta, si dhe monitorimin, raportimin dhe vlerësimin efektiv të programit. -Çelja e negociatave me BE.	-Pamjaftueshmëri e burimeve financiare të Fondit të Koherencës, mbështetur në kriteret e shpërndarjes në bazë të rezultateve. -Mungesa e të dhënave apo të dhëna minimale lidhur me punën e bërë në përmbushje të OZHQ-ve; -Mungesë e indikatorëve matës të progresit të bërë për arritjen e OZHQ-ve; -Nivel minimal angazhimi nga institucionet përgjegjëse dhe mos reflektim i angazhimit në plane veprimi për OZHQ-të; -Mungesë feedback/vlerësimi nga qytetarët që presupozohet të jenë përfituesit kryesorë të arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për arsye mosnjohje , mos përfshirje dhe mospjesëmarrje si aktorë interesi në këtë proces. Sulmet kibernetike përgjatë 2022, pandemia COVID-19, tërmeti 26 nëntor 2019.
---------------------------	--	--

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” ka si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e strukturave të ngritura për monitorimin, zbatimin, ndjekjen dhe raportimin e bërë kundrejt progresit të OZHQ. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv mbi menaxhimin dhe raportimin e bërë nga qeveria shqiptare lidhur me arritjen e OZHQ. Me anë të këtij objekti do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për periudhën 2017-2021.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si synim kryesor analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e menaxhimit dhe koordinimit ndërinstitucional me qëllim monitorimin, ndjekjen, zbatimin si dhe raportimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në këtë auditim nuk jemi fokusuar në zbatimin apo arritjen e objektivave të veçantë të OZHQ-ve, por janë parë në tërësi masat që janë marrë për ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve të cilat duhet të zbatojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Siç është theksuar edhe më lart subjektet kryesore që janë përzgjedhur në këtë auditim janë Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për vetë natyrën e këtij auditimi nuk parashikohen vizita në terren. Periudha e auditimit është 2017-2021, megjithatë edhe dokumente apo produkte/aktivitete të gjeneruara jashtë kësaj periudhe janë marrë në konsideratë nga grupi i auditimit.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Pyetja kryesore: A ka garantuar qeveria shqiptare monitorimin, ndjekjen dhe raportimin mbi nivelin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm?

Mesazhi i auditimit

Forcimi në vijimësi i harmonizimit dhe përfundimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëpërmjet përcaktimit të qartë dhe të plotë të strukturave përgjegjëse, afateve kohore, indikatorëve, buxheteve, si dhe rritja e nivelit të zbatimit dhe monitorimit duhet të jetë prioritet i qeverisë shqiptare, për të minimizuar varfërinë, mbrojtur mjedisin e për të siguruar mirëqenien e njerëzve.

4.1 A ka hartuar qeveria shqiptare politika të duhura dhe të përshtatshme për arritjen dhe zbatimin e OZHQ?

4.1.1 A kanë marrë masa institucionet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e politikave të dedikuara lidhur me OZHQ?

Shumë qeveri kanë krijuar strategji kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm. Këto strategji synojnë të sigurojnë një qasje kohezive kombëtare ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, për të përcaktuar një drejtim që vendi duhet të ndjekë dhe për të ndihmuar në përmbushjen e objektivave të vendosura nga marrëveshjet ndërkombëtare. Strategjitë ndryshojnë në cilësi. Disa thjesht mund të paraqesin apo prezantojnë politikat ekzistuese pa asnjë ndryshim themelor, ndërsa strategjitë më të mira përplojnë të pajtojnë ose ndërlidhin progresin ekonomik me aspektet mjedisore duke synuar integrim dhe qëndrueshmëri. Zakonisht strategjitë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshijnë një kuadër gjithëpërfshirës si dhe çështje që kanë të bëjnë me koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi progresin e bërë.²⁶ Një strategji e mirë duhet të përfshijë ose të shoqërohet nga një grup objektivash që duhen arritur si dhe tregues që matin progresin drejt përmbushjes së këtyre objektivave. Treguesit janë shpesh një lidhje jetike për të siguruar që qeveritë të mbajnë përgjegjësi për performancën e tyre kundrejt objektivave të tyre të zhvillimit të qëndrueshëm. Një strategji e fuqishme e zhvillimit të qëndrueshëm do të ketë marrëveshje për zbatimin e objektivave, matjen e progresit, raportimin e performancës dhe sigurimin e llogaridhënies.

Në auditimin e SAI-t të Norvegjisë citohet gjithashtu rëndësia e një strategjie të veçantë ose plan veprimi lidhur me zbatimin e OZHQ-ve. Nga auditimi rezultoi se një strategji e tillë nuk ishte hartuar

²⁶ GUIDE 5202, paragrafi 1.9 & 2.4.

nga qeveria e Norvegjisë.²⁷ Auditimi I SAI-t të Norvegjisë referon gjithashtu disa praktika të tjera të vendeve skandinave. Në rastin e Danimarkës, qeveria daneze në 2017 adoptoi një plan veprimi për zbatimin e Axfordës 2030 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, së bashku me strategjinë e titulluar “*The world 2030*”. Të njëjtën gjë bëri dhe qeveria finlandeze e cila në 2017 po ashtu miratoi një plan kombëtar për Axfordën 2030.²⁸

Në auditimin e SAI-t të Kanadasë lidhur me OZHQ në vitin 2018, rezultoi se nuk kishte qasje formale për zbatimin e Axfordës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga ana e qeverisë kanadeze. Ndërsa në auditimin e vitit 2021 për të njëjtën tematikë, rezultoi se qeveria kanadeze kishte hartuar Strategjinë Kombëtare për Axfordën 2030, strategji të cilën e kishte diskutuar gjerësisht me qytetarët e saj.²⁹ Në 2018 u themelua Njësia e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, një strukturë e ngritur brenda Departamentit të ESDC (*Employment and Social Development Canada* – Punësimi dhe Zhvillimi Social i Kanadasë). Detyra kryesore e kësaj njësie ishte të hartonte Strategjinë për Axfordën 2030.³⁰ Kjo strategji rekomandoi disa elementë të rëndësishëm që duheshin patur në konsideratë për të zbatuar Axfordën 2030 të cilat ishin:

- leadership, qeverisje dhe koherencë e politikave;
- ndërgjegjësim, angazhim dhe partnership;
- llogaridhënie, transparencë dhe raportim;
- investime dhe financime në OZHQ.

Në raportin e auditimit të SAI-t të Kanadasë rezultoi se qeveria nuk kishte krijuar një plan veprimi që do të përcaktonte qartë se si të gjithë departamentet dhe agjencitë federale do të mbështesnin zbatimin në nivel kombëtar të Axfordës 2030. Ky konstatim ka rëndësi sepse një plan zbatimi do të përcaktonte prioritetet dhe do të përshkruante qartë mënyrën se si qeveria federale do të integronte OZHQ në proceset e saj. Si rezultat, Departamentit të ESDC ju rekomandua hartimi i një plani zbatimi i cili do të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për arritjen dhe zbatimin e OZHQ-ve, do të garantojë bashkëpunim efektiv me strukturat e tjera të qeverisë dhe palët e interesit si dhe të përcaktojë qartë mënyrën e raportimit lidhur me progresin e bërë ndaj arritjes së OZHQ-ve. Ky rekomandim u pranua nga Departamenti i ESDC i cili garantoj realizimin e këtij plan veprimi brenda vitit 2021.³¹

²⁷ <https://www.riksrevisjonen.no/globalassets/reports/en-2020-2021/document-3-3-the-national-follow-up-of-the-sustainable-development-goals.pdf> Kapitulli 5.1


²⁸ <https://www.riksrevisjonen.no/globalassets/reports/en-2020-2021/document-3-3-the-national-follow-up-of-the-sustainable-development-goals.pdf> Kapitulli 2.2

²⁹ Raporti i Kanadasë, paragrafi 1.27.

³⁰ Raporti i Kanadasë, paragrafi 1.32

³¹ Raporti i Kanadasë, paragrafi 1.45

Fig.3. Cikli i menaxhimit të performancës



Burimi: GUID 5202

Udhërrëfyesi për arritjen e OZHQ

Në Urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 22.05.2017, “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëm” në pikën 4, “a”, theksohet se grupi ndërinstytucional i punës ka për detyrë përgatitjen e këtij udhërrëfyesi brenda vitit 2017.

Në Urdhrin e Kryeministrit nr. 63, datë 12.5.2017, “Për ngritjen e Komitetit ndërministror për arritjen e objektivate të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm”, theksohet se ky Komitet ka për detyrë të diskutojë udhërrëfyesin për arritjen e OZHQ-ve dhe të japë dakordësinë e tij për ta paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave duke kërkuar edhe raportim për ecurinë e tij. Për vetë kompleksitetin e Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëm një udhërrëfyesi i tillë do të ndikonte pozitivisht në monitorimin, ndjekjen dhe raportimin e tyre. Në auditimin e SAI-t të Norvegjisë rezultoi se Ministria e Financave e këtij vendi ka hartuar udhëzues për ministritë e tjera lidhur me raportimin e objektivate të zhvillimit të qëndrueshëm në buxhetin kombëtar, duke e vënë theksin në objektivat dhe qëllimet (*targets*) më sfiduese dhe ka dhënë udhëzime për përdorimin më të madh të indikatorëve që nga viti 2018.³² Nisur nga praktikat e mira ndërkombëtare si dhe kriterëve të vendosura në Urdhrin me nr. 63 të Kryeministrit të cituar më sipër, grupi i auditimit u fokusua dhe formuloi pyetje gjatë pyetësorëve dhe intervistave të zhvilluara me subjektet nën auditim që kanë të bëjnë me udhëzimin e institucioneve përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e OZHQ-ve. Pyetjes nëse Grupi Ndërinstytucional i punës i krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 70, Kryeministria iu përgjigj duke cituar se janë hartuar “Integrimi i OZHQ nëpërmjet SKZHI” (*SDG Mainstreaming through the National Strategy for Development and*

³² <https://www.riksrevisjonen.no/globalassets/reports/en-2020-2021/document-3-3-the-national-follow-up-of-the-sustainable-development-goals.pdf> Kapitulli 2.4

Integration)³³. Sipas Kryeministritë ky dokument paraqet nivelin e integritimit në SKZHI të treguesve të kuadrit të OZHQ-ve, si edhe jep rekomandime të karakterit orientues, për ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, në lidhje me përthyerjen e OZHQ-ve në kuadrin strategjik të vendit. Gjithashtu, në janar të 2018, është miratuar nga Komiteti Ndërmintor për OZHQ-të dokumenti “Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese” (*Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with existing Sectoral Policies*)³⁴. Ky raport, përveçse paraqet statusin për sistemin monitorues për synimin përkatës dhe sfidat për zbatim, sipas Kryeministritë paraqet edhe rekomandime të karakterit orientues, për institucionet qendrore dhe ministritë e linjës, për të ardhmen për kuadrin e politikave përkatëse dhe institucionet përgjegjëse kombëtare.

Referuar përgjigjeve të subjekteve nën auditim, Qasja e Qeverisë Shqiptare konsiston në përthyerjen apo harmonizimin e Axshendës 2030 Për Zhvillimin e Qëndrueshëm në sistemet dhe mekanizmat e vendit për planifikimin strategjik dhe të politikave, me qëllim eficiencën dhe efektivitetin për proceset planifikuese të vendit. Në këtë kontekst, dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2015-2020, i miratuar me VKM Nr. 348, dt.11.5.2016, si edhe dokumentet e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara me VKM, përbëjnë dokumentet e miratuara zyrtarisht që përthyejnë harmonizojnë dhe përfshijnë OZHQ-të. Në këtë perspektivë, kuadri strategjik kombëtar është orientuar për të siguruar harmonizimin dhe lidhjen midis prioritetëve kombëtare me OZHQ-të. Madje, nëpërmjet SKZHI 2020 dhe dokumenteve strategjike sektoriale/ ndërsektoriale është synuar të krijohet harmonizimi i prioritetëve kombëtare me Axshendën e Integritimit Evropian të vendit dhe Axshendën 2030. Shkalla e harmonizimit të kuadrit OZHQ me kuadrin strategjik të vendit, synohet të rritet më tej në dokumentin që është në proces hartimi të SKZHI 2030 (si edhe një seri dokumentesh strategjike sektoriale në përgatitje).

Gjetje

1. Qeveria shqiptare ka hartuar dhe miratuar SKZHI 2015-2020, por nuk ka strategji të veçantë të dedikuara ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm shoqëruar me një plan veprimi i cili do të mundësonte dhe do të lehtësonte arritjen e OZHQ. Duke patur në konsideratë edhe nivelin e ulët të harmonizimit të politikave sektoriale kombëtare me OZHQ-të, atëherë risku për të arritur dhe zbatuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm rritet dhe më shumë.
2. Udhërrëfyeni për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk është hartuar nga grupi ndërinstitutional i punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 70. Raporti “Integritimi i OZHQ nëpërmjet SKZHI” dhe “Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese” nuk e justifikojnë mungesën e tij si dhe nuk udhëzojnë institucionet përgjegjëse për arritjen e OZHQ për mënyrën se si ato duhet të monitorojnë, vlerësojnë, ndjekin dhe raportojnë mbi OZHQ. Të dy këto raporte vlerësojnë respektivisht integritimin, harmonizimin dhe përthyerjen e politikave ekzistuese me OZHQ dhe japin rekomandime dhe orientime se si politikat ekzistuese të integrohen dhe harmonizohen më shumë me OZHQ.

Konkluzione

1. Mungesa e strategjisë dhe planit të veprimit dedikuar ndaj OZHQ, niveli jo i lartë i harmonizimit/përthyerjes së politikave sektoriale kombëtare me OZHQ si dhe mungesa e Udhëzuesit të posaçëm për mënyrën e monitorimit, ndjekjes, zbatimit dhe raportimit periodik të OZHQ, ngadalëson arritjen dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e**

³³<https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.30->

[20SDG%20mainstreaming%20through%20the%20National%20Strategy%20for%20Integration%20and%20Development%202015-2020%20%28NSDI%20II%29.pdf](https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.30-20SDG%20mainstreaming%20through%20the%20National%20Strategy%20for%20Integration%20and%20Development%202015-2020%20%28NSDI%20II%29.pdf)

³⁴<http://www.un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>

Auditimit” nga z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrit, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 1 të Projekt Raportit “Mungesa e një strategjie dhe plani veprimi të dedikuar ndaj OZHQ si dhe niveli i ulët i harmonizimit/përthyerjes së politikave sektoriale kombëtare me OZHQ cënon arritjen dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm” është si më poshtë:

-Në lidhje me konkluzionin e mësipërm theksojmë se për përthyerjen e OZHQ-ve në politikat kombëtare është ndjekur qasja për integrimin e tyre në sistemet dhe instrumentet kombëtarë të proceseve të planifikimit dhe monitorimit, me qëllim sigurimin e eficiencës lidhur me: (i) përdorimin e mekanizmave të sistemeve të vendit; (ii) evitimin e mbivendosjeve të proceseve planifikuese/dokumenteve strategjike planifikues; (iii) përdorimin efektiv të burimeve njerëzore; (iii) planifikimin realist të burimeve në kuadër të Agjendës 2030, si pjesë e agjendës zhvillimore të vendit; (iv) evitimin e raportimeve të dyfishta në kuadër të ndjekjes së zbatimit. 3 Aktualisht SKZHI 2030 (objektivat dhe seti i treguesve të saj), strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale (objektivat dhe seti i treguesve të tyre), si dhe publikimet periodike të INSTAT përbëjnë kuadrin e plotë të një plani për arritjen e OZHQ-ve.

Së fundmi, është publikuar për konsultim publik draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (linku ne vijim: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_DraftStrategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf), koordinuar nga Agjencia SASPAC, e cila ka integruar në shkallë të lartë OZHQ-të, bazuar edhe në metodologjinë përkatëse për përgatitjen e SKZHI 2030, të miratuar me Urdhërin nr.157 të Kryeministrit, datë 30.12.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në konkluzionin nr. 1 të Projekt Raportit të Auditimit, grupi i auditimit është shprehur mbi mungesën e strategjisë së dedikuar mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe nivelin e ulët të përafrimit/përthyerjes së tyre me kuadrin kombëtar të politikave ekzistuese. “Niveli i përafrimit midis synimeve të OZHQ-ve me kuadrin kombëtar të politikave ekzistuese nuk është i mjaftueshëm për të treguar përafrimin e objektivave kombëtare me kornizën e OZHQ-ve”. Ky është një përkufizim i “Raportit të Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese”, mbi të cilin grupi i auditimit është bazuar për të dalë në këtë konkluzion.

Pretendimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 2 të Projekt Raportit “Të gjitha institucionet përgjegjëse për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk janë udhëzuar me anë të një Udhëzuesi të posaçëm për mënyrën e monitorimit, ndjekjes, zbatimit dhe raportimit periodik të OZHQ” është si më poshtë:

-Në janar të 2018, Komiteti Ndërmintor për OZHQ-të ka miratuar dokumentin “Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with existing Sectoral Policies”. Ky raport, përveçse paraqet statusin për sistemin monitorues për synimin përkatës dhe sfidat për zbatim, paraqet edhe rekomandime të karakterit orientues, për institucionet qendrore dhe ministritë e linjës, për të ardhmen për kuadrin e politikave përkatëse dhe institucionet përgjegjëse kombëtare. Raporti fokusohet dhe specifikon përgjegjësitë e ministrive të linjës dhe institucioneve për secilën nga OZHQ-të duke përcaktuar njëkohësisht dhe përafrimin me kuadrin strategjik dhe politikat respektive. Në këtë kuadër, rekomandimet e Raportit të miratuara në KOZHQ kanë derivuar në akte ligjore (VKM, Urdhëra, etj), të cilat kanë konsistuar në miratimin e dokumenteve strategjike, të hartuar nga ministritë e linjës, si edhe përvijimin e zbatimit të dokumenteve strategjike sipas fushave respektive të përgjegjësisë institucionale. Në Raport, për secilën nga target-et e OZHQ-ve respektive jepen edhe “Sfidat për procesin e zbatimit të SDG dhe rekomandimet për politikat dhe institucionet kombëtare”, të cilat janë zbatuar praktikisht në vijimësi me miratimin me VKM të dokumenteve strategjike sipas fushave përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa i përket konkluzionit nr. 2, si fillim duhet theksuar se artikulli dhe observacioni i Kryeministrit është i njëjtë me përgjigjet zyrtare që janë sjellë nga Kryeministria përgjatë auditimit. Pra, në këtë observacion nuk paraqitet ndonjë argument ose fakt i ri sa i përket këtij konkluzioni.

Rekomandime

- 1.1 Kryeministria në rolin e koordinatorit kryesor të monitorimit dhe zbatimit të OZHQ së bashku me ministrinë e linjës të marrin masa për të rritur nivelin e harmonizimit të politikave sektoriale kombëtare me OZHQ.

Në vazhdimësi

- 2.1 Grupi ndërinstytucional i punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 70 të marrë masa për hartimin e Udhërrëfyesit me udhëzime të qarta e të sakta për arritjen (monitorimin, ndjekjen dhe raportimin periodik) e OZHQ dhe më tej ta përcjellë atë në të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera që kanë përgjegjësi për arritjen e OZHQ.

Qershor 2023

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, *nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrit*, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit lidhur me rekomandimin nr. 1.1 të Projekt Raportit “Kryeministria në rolin e koordinatorit kryesor të monitorimit dhe zbatimit të OZHQ së bashku me ministrinë e linjës të marrin masa për të hartuar një plan veprimi të dedikuar ndaj OZHQ dhe të rrisin nivelin e harmonizimit të politikave sektoriale kombëtare me OZHQ” është si më poshtë:

Shprehemi që nuk jemi dakort me pjesën e parë të këtij rekomandimi: “të marrin masa për të hartuar një plan veprimi të dedikuar ndaj OZHQve”. Qasja e Qeverisë Shqiptare konsiston në përthyerjen dhe harmonizimin e OZHQ-ve me kuadrin strategjik të vendit, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 dhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Strategjitë sektoriale kanë impakt në buxhetimin e fondeve në 2 Programin Buxhetor Afatmesëm, përmes planeve të veprimit të tyre të buxhetuara/kostuara në mënyrë indicative, të cilat përbëjnë instrumentat e plotë për arritjen e OZHQ-ve. Përsa kohë që planifikimi dhe monitorimi i OZHQve sigurohet përmes instrumenteve të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si edhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale, bazuar edhe në Urdhërin nr.157 të Kryeministrit, datë 30.12.2021, gjykojmë që është mbivendosje përgatitja e një plani veprimi të dedikuar ndaj OZHQve. Në këtë kontekst, krijimi i një plani, të dedikuar ndaj OZHQ-ve, sjell rrisjen e mungesës së eficiencës dhe efektivitetit për procesin. Në rradhtë të parë, kemi dublikim të instrumenteve planifikuese, që janë SKZHI 2030, strategjitë sektoriale, përmes të cilave kryhet përthyerja e OZHQve. Së dyti, nëse do të përgatitej një plan për OZHQ-të, kjo sjell gjithashtu mbivendosje të informacionit që përdoret për dokumentin e planit kundrejt informacionit që përdoret për dokumentin e strategjive. Së treti, përgatitja e një plani të OZHQve kërkon një angazhim të shumëfishtë për institucionet dhe personat që përfshihen, si në planifikim ashtu edhe në raportim, që sjell mungesë efieciencë në përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky observacion u mor në konsideratë nga grupi i auditimit dhe nuk do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimi i subjektit lidhur me rekomandimin e Projekt Raportit nr. 2.1 “Grupi ndërinstytucional i punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 70 të marrë masa për hartimin e Udhërrëfyesit me udhëzime të qarta e të sakta për arritjen (monitorimin, ndjekjen dhe raportimin periodik) e OZHQ dhe më tej ta përcjellë atë në të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera që kanë përgjegjësi për arritjen e OZHQ” është si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit nr.70 të Kryeministrit, vlerësojmë se është e nevojshme të zhvillohet një analizë paraprake për instrumentat e përdhërjes së OZHQ-ve dhe përgjegjësitë dhe funksionet e institucioneve, duke konsideruar Urdhërin e Kryeministrit Nr. 157, datë 31.12.2021 “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 - 2030”, si edhe VKM nr.642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”. Në bazë të gjetjeve të analizës, do të vijohet puna në bazë të rekomandimeve përkatëse, përfshirë edhe nevojën për përgatitjen e një Udhërrëfyesi të për arritjen e OZHQ-ve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për këtë rekomandim grupi i auditimit është bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 70, datë 22.05.2017, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesi për arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm” i cili në pikën 4, “a”, përcakton hartimin e Udhërrëfyesi për arritjen e OZHQ-ve brenda vitit 2017. Urdhëri i Kryeministrit Nr. 157, datë 31.12.2021 “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 – 2030 i cili përmendet në këtë observacion nuk parashikon dhe nuk përcakton përgatitjen e Udhërrëfyesi për arritjen e OZHQ-ve. Për arsyet e mësipërme, observacioni nuk merret në konsideratë.

4.1.2 A ka përcaktuar dhe përafruar qeveria shqiptare indikatorët e OZHQ në kontekstin kombëtar shqiptar?

Objektivat dhe qëllimet (*targets*) do të ndiqen dhe rishikohen duke përdorur një sërë treguesish globalë. Këto do të plotësohen me indikatorë në nivel rajonal dhe kombëtar të cilët do të zhvillohen nga shtetet anëtare të cilat janë zotuar për arritjen dhe zbatimin e 17 OZHQ³⁵. Axhenda 2030 ka përcaktuar 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 169 qëllime (*targets*), së bashku me mbi 230 tregues për të matur progresin global³⁶. Objektivat dhe qëllimet (*targets*) e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë të integruara, të pandashme dhe të aplikueshme në nivel global duke marrë në konsideratë realitete të ndryshme kombëtare, kapacitete dhe nivele të ndryshëm zhvillimi si dhe prioritete e politika kombëtare respektive. Qëllimet (*targets*) përcaktohen si synime globale ku qeveritë vendosin objektivat e veta kombëtare duke mbajtur në konsideratë rrethanat kombëtare. Çdo qeveri duhet gjithashtu të vendosë se si këto objektiva dhe qëllime globale do të përfshihen në planifikimet e proceseve kombëtare, politikat dhe strategjitë. Është e rëndësishme të bëhet lidhja mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe proceseve të tjera në fushat ekonomike, sociale dhe mjedisore.³⁷

Në raportin e auditimit të SAI-t të Norvegjisë ka rezultuar se shumica e ministrive kanë vënë në dukje faktin se objektivat e përgjithshme kombëtare mbivendosen në masë të madhe me qëllimet (*targets*) e objektive të zhvillimit të qëndrueshëm. Një rast konkret ishte edhe deklarata e Ministrisë së Klimës dhe Mjedisit lidhur me objektivat kombëtare të klimës dhe mjedisit. Ministria theksoi se objektivat kombëtare të klimës dhe mjedisit nuk janë përcaktuar zyrtarisht si objektivat e Norvegjisë lidhur me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ministria theksoi se Parlamenti i Norvegjisë nuk ka përcaktuar një lidhje midis objektive kombëtare dhe objektive të zhvillimit të qëndrueshëm.³⁸

Raporti i harmonizimit të OZHQ për Shqipërinë (Albania Report on the Harmonization of SDG) analizon gatishmërinë e Shqipërisë për të zbatuar OZHQ duke patur në konsideratë kornizën institucionale dhe strategjike të vendit tonë dhe vlerëson implikimet/ndërlidhjet e OZHQ në fushat kryesore në Shqipëri. Niveli i mbivendosjes ndërmjet qëllimeve (*targets*) të OZHQ dhe fushave të politikave të SKZHI II 2015 – 2020, duke përfshirë strategjitë kombëtare dhe dokumentet e politikave

³⁵ Axhenda 2030 Për Zhvillimin e Qëndrueshëm, paragrafi 75.

³⁶ Numri i indikatorëve ka ndryshuar. Sot janë 248 indikatorë sipas kornizës së indikatorëve globalë të përcaktuar nga Grupi i Ndër Ekspertëve dhe Agjencive mbi OZHQ – Inter Agency and Expert Group on SDG.

³⁷ Axhenda 2030 Për Zhvillimin e Qëndrueshëm, paragrafi 55.

³⁸ Raporti i auditimit të Norvegjisë, Kapitulli 5.4

ekzistuese, nuk është i mjaftueshëm për të treguar përafrimin e objektivave kombëtare për secilën fushë të politikave, me ato të përfshira në OZHQ. Për të vlerësuar këtë marrëdhënie, çdo qëllim (*targets*) i OZHQ-ve është përputhur me objektivin e politikës kombëtare përkatëse dhe rezultati është klasifikuar në katër grupe të mundshme, bazuar në shkallën e përafrimit:³⁹

- (i) Përafruar;
- (ii) Pjesërisht të përafruar;
- (iii) Jo i përafruar;
- (iv) Nuk zbatohet për Shqipërinë.

Tab. 3 Numri i qëllimeve (*targets*) të OZHQ sipas përafrimit me Kornizën Strategjike Kombëtare

	<i>Përafruar</i>	<i>Pjesërisht të përafruar</i>	<i>Jo i përafruar</i>	<i>Nuk aplikohet</i>
OZHQ 1	4	3	0	0
OZHQ 2	3	5	0	0
OZHQ 3	12	1	0	0
OZHQ 4	4	5	1	0
OZHQ 5	3	5	1	0
OZHQ 6	2	5	1	0
OZHQ 7	5	0	0	0
OZHQ 8	8	3	0	1
OZHQ 9	4	2	0	2
OZHQ 10	1	5	1	3
OZHQ 11	2	7	0	1
OZHQ 12	1	5	2	1
OZHQ 13	1	1	1	2
OZHQ 14	0	2	7	1
OZHQ 15	0	10	2	0
OZHQ 16	6	6	0	0
OZHQ 17	2	7	0	10
TOTALI	58	72	18	21

Burimi: Raporti i harmonizimit të OZHQ për Shqipërinë, fq 27

Qasja për të vlerësuar boshllëqet e politikave me kuadrin e OZHQ, përdor sasinë e shkallës së përafrimit për çdo objektiv të OZHQ, me politikat kombëtare. Për çdo objektiv të OZHQ aplikohet një koeficient tregues i shtrirjes prej 90% për objektivat e konsideruara si të përafruara, 50% për objektivat e konsideruar si pjesërisht të përafruara dhe 10% për objektivat e konsideruar si të pa përafruara. Objektivat e pazbatueshme për Shqipërinë përjashtohen nga ky përcaktim pasi kanë vlerë të papërfillshme ose nuk kanë kuptim për politikën e brendshme. Duke caktuar këta koeficientë tregues, llogaritet niveli i përputhshmërisë apo përafrimit/harmonizimit me politikat kombëtare për çdo OZHQ. Përafrimi mesatar për të gjitha qëllimet e OZHQ sipas kësaj llogaritje është 62% dhe në mënyrë të detajuar për çdo OZHQ janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

Tab. 4 Përafrimi i *targets* të OZHQ

Përafrimi: Qëllimet e OZHQ/ Prioritetet kombëtare	OZHQ	Shkalla e shtrirjes
Përafrim shumë i mirë (>75%)	OZHQ 7	90%
	OZHQ 3	87%
	OZHQ 8	79%
	OZHQ 9	77%
Shtrirje e mirë (50% - 75%)	OZHQ 1	73%
	OZHQ 16	70%
	OZHQ 2	65%
	OZHQ 4	62%

³⁹ Raporti i harmonizimit të OZHQ për Shqipërinë, fq 26

	OZHQ 5	59%
	OZHQ 11	59%
	OZHQ 17	59%
	OZHQ 6	55%
	OZHQ 10	50%
	OZHQ 13	50%
Rreshtimi i pjesshëm (25% - 50%)	OZHQ 12	45%
	OZHQ 15	43%
Shtrirje e kufizuar (<25%)	OZHQ 14	19%

Burimi: Raporti i harmonizimit të OZHQ për Shqipërinë, fq 28.

Kuadri i monitorimit: Treguesit globalë

Arritja e suksesshme e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm kërkon përcaktimin dhe mobilizimin e burimeve institucionale në Shqipëri, jo vetëm për integrimin e OZHQ-ve në strategjitë, politikat dhe planet kombëtare, por edhe për monitorimin e proceseve për të raportuar mbi progresin e tyre. Kapacitetet e përmirësuara për të përgatitur të dhëna më të mira, më të shpejta, të detajuara dhe të besueshme do ta mbështesin Shqipërinë në përparimin e qëndrueshëm në Axhendën e Zhvillimit 2030. Për të siguruar një përputhshmëri optimale të kuadrit të monitorimit vendas me standardet ndërkombëtare, sfida e “*Raportit të Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese*” është të vlerësojë adoptimin e kornizës globale të indikatorëve të OZHQ-së në kontekstin kombëtar shqiptar si përpjekja e parë për të krijuar një sistem monitorimi të SDG-ve në vendin tonë. Shqipëria në të ardhmen mund të marrë në konsideratë integrimin gradual të indikatorëve të tjerë të brendshëm të disponueshëm në vend, në mënyrë që të përmirësohet kuadri i monitorimit për OZHQ-të. Përdorimi i kornizës globale të indikatorëve, në mënyrën më të mirë të disponueshme në Shqipëri, do të siguronte gjithashtu që vendi të përdorë një kuadër të pranuar ndërkombëtarisht për monitorimin e OZHQ-ve dhe ky raport ofron informacionin dhe të dhënat më të fundit për të gjithë treguesit që monitorohen aktualisht në Shqipëri. Mekanizmi i monitorimit duhet të përfshijë qëllime (*targets*) për vitin 2030 për secilin prej indikatorëve, megjithëse kjo detyrë duket një sfidë e madhe për institucionet pasi nuk janë vendosur objektiva për vitin 2030 dhe për treguesit e disponueshëm. Vetëm disa institucione kanë objektiva specifike për vitin 2020. Është e rëndësishme të theksohet se mekanizmi monitorues i përfshirë në SKZHI II 2015 – 2020 dhe në dokumentet e tjera strategjike kombëtare, është shumë i kufizuar sa i përket ndërlidhjes me kornizën globale të indikatorëve. Nga 232 indikatorë globalë, vetëm 12 prej këtyre indikatorëve përdoren për gjurmimin e progresit brenda SKZHI II, dhe 14 indikatorë të tjerë përdoren në strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave, ndërsa numri total i treguesve të brendshëm në këto dokumente është përkatësisht 50 në SKZHI II, dhe më shumë se 1200 në dokumentet e tjera. Duke e njohur këtë mangësi, është thelbësore të merret në konsideratë disponueshmëria në nivel kombëtar e indikatorëve të tjerë referuar kornizës globale të indikatorëve dhe këto të integrohen në politikat kombëtare sa më shpejt të jetë e mundur.

Gjatë realizimit të Raportit të Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese, vlerësimi i kuadrit global të treguesve u krye në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in dhe institucionet kryesore të përfshira në këtë proces, duke përfshirë mbështetjen e vazhdueshme të shumë agjencive të OKB-së. Të dhënat për një pjesë të mirë të treguesve mbledhen dhe disponohen nga INSTAT, ndërsa pjesa më e madhe e treguesve të tjerë për të cilët disponohen të dhëna bazohen në informacione nga institucione të tjera në vend. Për disa tregues, informacioni nuk disponohet në vend, por publikohet nga organizata ndërkombëtare, si FMN etj. Indikatorët nga korniza globale që disponohen në Shqipëri dhe për të cilët të dhënat mbledhen nga INSTAT, në shumicën e rasteve janë në përputhje me kërkesat e metodologjisë specifike të vendosur nga grupi i punës i OKB-së. Megjithatë, ekzistojnë dy sfida kryesore për këtë grup treguesish: Së pari, periodiciteti i mbledhjes së të dhënave për disa indikatorë nuk është i rregullt dhe në disa raste, informacioni më i fundit në dispozicion është shpesh

shumë i vjetër (për shembull: shumë indikatorë të varfërisë i referohen vitit 2012 dhe indikatorë të tjerë të shëndetit deri në vitin 2008). Së dyti, dimensionet dhe thellësia e ndarjes të kërkuara nga disa prej qëllimeve të OZHQ janë të pamjaftueshme në të dhënat e disponueshme aktualisht në Shqipëri (për shembull, disa qëllime kërkojnë ndarje sipas statusit të paaftësisë, një faktor që nuk merret parasysh për asnjë nga treguesit në Shqipëri). Indikatorët e tjerë për të cilët disponohet informacion nga institucionet vendase, shpeshherë u mungon standardizimi me metodologjinë e kërkuar, gjë që përbën një sfidë tjetër për përputhshmërinë e këtyre indikatorëve me kornizën globale. Gjithashtu, mungesa e metodologjisë së standardizuar edhe brenda vendit krijon konflikte në raportimin e të dhënave pasi informacioni i dhënë nga institucionet qeveritare ndryshon në disa raste nga informacioni i raportuar nga INSTAT. Duke qenë se mekanizmat e mbledhjes së të dhënave të përdorura nga INSTAT janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, është e rëndësishme që të riorganizohen më tej standardet dhe metodologjia për çdo tregues në sistemet e mbledhjes së të dhënave të përdorura nga institucionet e tjera qeveritare. Për këtë arsye, indikatorët në “Raportin e Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese” janë klasifikuar në pesë grupe - (i) të disponueshme, (ii) tregues për të cilët informacioni është i disponueshëm me përpjekje (për rastet kur një tregues përfshin llogaritje shtesë bazuar në informacionin ekzistues,; (iii) treguesit për të cilët informacioni është pjesërisht i disponueshëm, për ata tregues ku të dhënat e disponueshme nuk janë të mjaftueshme për të pasqyruar të gjitha dimensionet e treguesit; (iv) i padisponueshëm dhe (v) i pazbatueshëm për treguesit që nuk janë hartuar për Shqipërinë, por për grupe të tjera vendesh.⁴⁰ Bazuar në këto konsiderata, disponueshmëria e treguesve nga kuadri global, për çdo OZHQ dhe në total është paraqitur në tabelën më poshtë nr 5.

Tab. 5 Disponueshmëria e indikatorëve globalë në Shqipëri

Disponueshmëria e Treguesve Globalë në Shqipëri					
	<i>Të disponueshëm</i>	<i>Të disponueshëm me përpjekje</i>	<i>Pjesërisht të disponueshëm</i>	<i>Jo të disponueshëm</i>	<i>Jo të aplikueshme</i>
OZHQ 1	7	4	1	2	0
OZHQ 2	4	2	1	6	0
OZHQ 3	15	0	6	4	2
OZHQ 4	2	0	7	2	0
OZHQ 5	6	0	4	3	1
OZHQ 6	2	0	2	7	0
OZHQ 7	1	2	0	2	1
OZHQ 8	6	1	2	7	1
OZHQ 9	4	1	2	5	0
OZHQ 10	5	1	0	4	1
OZHQ 11	2	1	3	8	1
OZHQ 12	1	0	0	12	0
OZHQ 13	2	0	0	4	2
OZHQ 14	1	1	0	8	0
OZHQ 15	3	4	2	5	0
OZHQ 16	5	1	3	12	2
OZHQ 17	11	4	2	3	4
Totali	77	23	35	94	15

Burimi: Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese

⁴⁰ Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese, fq. 32

Aktualisht qeveria shqiptare është duke përgatitur SKZHI 2021-2030. Si pjesë e fazë parapërgatitore për SKZHI 2030, është përgatitur edhe draft analiza/diagnoza për situatën dhe progresin në politikat sektoriale në kuadër të draftit të SKZHI 2030, në periudhën maj-shtator 2021. Drafti u përgatit me mbështetjen e asistencës teknike të Zyrës së Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së. Ky draft konsideroi dokumente si Raporti Afatmesëm për SKZHI 2020; Multidimensional Review etj., si edhe dokumente dhe analiza të përgatitura nga organizata brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, gjatë periudhës parapërgatitore shkurt – tetor 2021, u përgatit edhe një draft i paketës metodologjike dhe draft urdhër për përgatitjen e SKZHI 2030 nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri. Kjo draft paketë iu kalua për konsolidim dhe kompetencë të mëtejshme Agjencisë SASPAC, në zbatim të VKM nr. 642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”. Referuar VKM nr. 642, datë 29.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” (SASPAC), përcaktohet Agjencia SASPAC si institucioni përgjegjës për hartimin e SKZHI 2030. Procesi i hartimit të SKZHI 2030 bazohet në Urdhërin e Kryeministrit nr. 157, datë 31.12.2021 “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 - 2030”, i cili përmban edhe Shtojcën 1 “Metodologjia për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030”.

Puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 – 2030 ka nisur me miratimin e Urdhërit Nr.157, të Kryeministrit, datë 30.12.2021, “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030”. Dokumenti që fakton procesin e fillimit të punës për SKZHI 2021 - 2030 është Urdhri i Kryeministrit, nr. 157, datë 30.12.2021 për "hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030". Në zbatim të këtij Urdhri, institucionet kanë filluar për përgatitjen e kontributeve përkatëse, nën koordinimin e SASPAK. Kontributet institucionale për SKZHI 2021 – 2030, sipas tematikave të përcaktuara edhe në Urdhër, janë prezantuar dhe diskutuar në 16 mbledhje të dedikuara me pjesëmarrje të gjerë, të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës qershor - korrik 2022. Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga ministritë e linjës, institucionet qendrore, institucionet e pavarura, përfaqësues të donatorëve, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të arsimit të lartë, përfaqësues të grupeve të interesit, etj. Drafti i SKZHI 2030 pritet të përfundojë procesin brenda vitit 2022.⁴¹

Për të pasur një panoramë më të qartë lidhur me harmonizimin (përthyerjen) e politikave ekzistuese kombëtare me kornizën e indikatorëve globale⁴², grupi i auditimit përzgjedhi disa *targets* shoqëruar me indikatorët përkatës për të parë nivelin e tyre të harmonizimit. Kështu sipas fushës së veprimtarisë të ministrive (konkretisht MTM dhe MSHMS) u përzgjedhën ato OZHQ dhe qëllime e indikatorë nga lista e kornizës së indikatorëve globale që kanë lidhje me veprimtarinë e MTM dhe MSHMS. Përzgjedhja u bë rastësore. Grupi i auditimit përpiloi për secilën ministri nga një tabelë të veçantë në të cilat u vendosën *targets* dhe indikatorë specifikë dhe të cilat u plotësuan nga këto dy ministri (Aneksi 2 dhe 3). Konkretisht grupi i auditimit përzgjedhi 8 qëllime dhe 17 indikatorë referuar listës së kornizës ndërkombëtare të indikatorëve të OZHQ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e MSHMS. Në mënyrë të detajuar, përmbajtjen e secilit prej këtyre qëllimeve dhe indikatorëve e gjeni në Aneksin 2. Edhe për MTM grupi i auditimit veproi me të njëjtën mënyrë. Për MTM u përzgjedhën 16 qëllime dhe 21 indikatorë referuar listës së kornizës ndërkombëtare të indikatorëve të OZHQ. Përmbajtjen e secilit prej tyre e gjeni në Aneksin 3. Nga përgjigjet e të dy ministrive rezultoi se një pjesë e indikatorëve nuk ishte përputhur/përafruar me listën e kornizës së indikatorëve globale. Harmonizimi dhe përafrimi i politikave kombëtare me kornizën globale të indikatorëve është një proces shumë i rëndësishëm sa i përket arritjes së OZHQ-ve. Edhe pse qeveria shqiptare ka bërë përpjekje për përafrimin e qëllimeve dhe indikatorëve kombëtarë me kornizën e qëllimeve dhe indikatorëve globalë, ka akoma vend për përmirësim sa i përket harmonizimit dhe përafrimit të tyre. Përafrimi mesatar për të gjitha qëllimet e OZHQ është 62%, ndërsa sa i përket indikatorëve, 32% e

⁴¹ Përgjigje zyrtare me e-mail nga Kryeministria më datë 21.10.2022

⁴² https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Framework%20after%202022%20refinement_Eng.pdf

kornizës globale të indikatorëve janë të disponueshëm në Shqipëri, 24% janë të disponueshëm me përpjekje ose pjesërisht të disponueshëm, 39% nuk janë të disponueshëm dhe 6% nuk janë të zbatueshme për Shqipërinë.⁴³ MSHMS me anë të politikave dhe strategjive të cilat harton dhe zbaton, nuk ka mundur të harmonizojë dhe përafrojë plotësisht si dhe të përcaktojë qartë indikatorët 3.5.2; 3.7.2; 3.9.1; dhe 3.9.2 sipas listës së kornizës së indikatorëve globalë.⁴⁴ Indikator 3.5.2 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “konsumi i alkoolit në litra për frymë (për njerëzit mbi 15 vjeç) brenda një viti kalendarik”. Nga dokumentet politike/strategjike ekzistuese rezultoi se nuk ka një indikator të tillë kombëtar që të përcaktojë qartë konsumin e alkoolit në litra për frymë brenda një viti për këtë grupmoshë. I vetmi përkufizim në politikat kombëtare është “15 % e adoleshentëve kanë qenë të dehur të paktën një herë në jetë”. Kujtojmë se në Strategjinë e 2016-2020, fq. 94 (e cila nuk është më në fuqi) ekzistonte një indikator i tillë i cili ishte shumë i qartë dhe i lidhur me indikatorin global të OZHQ.

- Indikator 3.7.2 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “shkalla e lindjeve nga ana e adoleshentëve (10-14 vjeç; 15-19 vjeç) për 1000 femra në këtë grupmoshë”. Në dokumentet politike/strategjike të vendit tonë nuk është përcaktuar një indikator i tillë.
- Indikator 3.9.1 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit”. Në dokumentet politike/strategjike të vendit tonë nuk është përcaktuar një indikator i tillë.
- Indikator 3.9.2 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ujit dhe higjienës sanitare”. Edhe ky indikator nuk është i përcaktuar në dokumentet politike/strategjike të vendit tonë.

MTM me anë të politikave dhe strategjive të cilat harton dhe zbaton, nuk ka mundur të harmonizojë dhe përafrojë plotësisht si dhe të përcaktojë qartë indikatorët 12.4.2; 12.5.1 dhe 14.2.1 sipas listës së kornizës së indikatorëve globalë.

- Indikator 12.4.2 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “mbetjet e rrezikshme të gjeneruara për frymë” dhe raporti i mbetjeve të rrezikshme të trajtuara, sipas llojit të trajtimit”. Në dokumentet politike/strategjike të vendit tonë nuk është përcaktuar një indikator i tillë.
- Indikator 12.5.1 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “shkalla kombëtare e riciklimit, materialet e ricikluara në tonë”. Edhe për këtë indikator nuk ka asnjë tregues/indikator të përcaktuar në politikat/strategjitë e vendit tonë.
- Indikator 14.2.1 i listës së kornizës ndërkombëtare është përcaktuar si “vendet që përdorin qasje të bazuara në ekosistem për të menaxhuar zonat bregdetare”. Në dokumentet politike/strategjike të vendit tonë nuk është përcaktuar një indikator i tillë.

Gjetje

3. Me gjithë punën e bërë nga qeveria shqiptare në përpjekje për përafrimin e qëllimeve dhe indikatorëve kombëtarë me kornizën e qëllimeve dhe indikatorëve globalë, ka akoma vend për përmirësim sa i përket harmonizimit dhe përafrimit të tyre, sepse përafrimi mesatar për të gjitha qëllimet e OZHQ është 62%.
4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka mundur të harmonizojë dhe përafrojë plotësisht si dhe të përcaktojë qartë indikatorët 3.5.2; 3.7.2; 3.9.1; dhe 3.9.2 sipas listës së kornizës së indikatorëve globalë.
5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nuk ka mundur të harmonizojë dhe përafrojë plotësisht si dhe të përcaktojë qartë indikatorët 12.4.2; 12.5.1 dhe 14.2.1 sipas listës së kornizës së indikatorëve globalë.

⁴³ Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese, fq. 33

⁴⁴ https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Framework%20after%202022%20refinement_Eng.pdf

Konkluzione

1. Përcaktimi i qëllimeve dhe indikatorëve në kontekstin kombëtar shqiptar referuar kornizës globale të indikatorëve si dhe përafrimi me politikat ekzistuese të vendit tonë do të mundësonte harmonizimin e plotë të tyre me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe do të lehtësonte punën e institucioneve përgjegjëse për monitorimin, ndjekjen, arritjen dhe raportimin e tyre lidhur me OZHQ.
2. Mungesa e harmonizimit dhe përcaktimit të qartë referuar listës së indikatorëve globale vështirëson dhe pamundëson monitorimin, ndjekjen dhe arritjen e OZHQ nga ana e këtyre dy ministrive.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, **nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë**, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 3 të Projekt Raportit “Përcaktimi dhe përafrimi i qëllimeve dhe indikatorëve në kontekstin kombëtar shqiptar referuar kornizës globale të indikatorëve është ende në një nivel që ka nevojë për integrim dhe adoptim më të lartë sa i përket harmonizimit të tyre. I gjithë kuadri i politikave ekzistuese të vendit tonë nuk mundëson harmonizimin e plotë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, çka e vështirëson punën e institucioneve përgjegjëse për monitorimin, ndjekjen, arritjen dhe raportimin e tyre lidhur me OZHQ” është si më poshtë:

Është e rëndësishme të kuptohet se OZHQ-të shërbejnë si pika referimi në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal për politikat e zhvillimit, si dhe janë një mundësi e mirë krahasimi midis vendeve, por faktikisht janë politikat kombëtare ato që ndikojnë në arritjen e OZHQ-ve në të gjitha nivelet (kombëtar, rajonal, global). Theksojmë se duke iu referuar praktikave dhe eksperiencave ndërkombëtare:

- nuk rezulton që ndonjë vend të jetë angazhuar për të raportuar për të gjithë treguesit e dakortësuar globalisht, madje ka vende të cilat kanë përcaktuar edhe prioritete vetëm për disa OZHQ, por secili ka vendosur prioritetet e tij kombëtare, të cilat gjithashtu i shërbejnë arritjes së OZHQ-ve.

- Për listën e treguesive të dakortësuar globalisht sistemi i Kombeve të Bashkuara ka përcaktuar ‘custodian agencies’, të cilat për disa prej treguesve i mbledhin vetë të dhënat dhe raportojnë (rastet kur treguesi parashikon numrin e vendeve që kanë kuadër legjislativ mbi një çështje të caktuar, p.sh. treguesi 5.a.2 measuring “the percentage of countries where the legal framework (including customary law) guarantees women’s equal rights to land ownership and/or control.”)

- Treguesit e OZHQ-ve klasifikohen sipas Kriteve/Përkufizimeve të klasifikimit në nivele (Tier), ku siç shihet në shpjegimin e mëposhtëm, grupi i intreguesve të Tier 3 nuk ka ende metodologji apo standarte të vendosura ndërkombëtarisht: o Tier 1: Treguesi është konceptualisht i qartë, ka një metodologji dhe standarde të vendosura ndërkombëtarisht, dhe të dhënat prodhohen rregullisht nga vendet për të paktën 50 për qind të vendeve dhe të popullsisë në çdo rajon ku treguesi është i rëndësishëm.

- o Tier 2: Treguesi është konceptualisht i qartë, ka një metodologji të vendosur ndërkombëtarisht dhe standarde janë të disponueshme, por të dhënat nuk prodhohen rregullisht nga vendet.

- o Tier 3: Nuk ka ende metodologji ose standarde të vendosura ndërkombëtarisht për treguesin, por metodologjia/standartet janë duke u zhvilluar (ose do të) testohen. (Në sesionin e 51-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara, korniza globale e treguesve nuk përmban asnjë tregues të nivelit III).

- Që nga 4 shkurt 2022: Klasifikimi i nivelit të përditësuar përmban 136 tregues të Tier I, 91 tregues të Tier II dhe 4 tregues që kanë nivele të shumta (përbërës të ndryshëm të treguesit klasifikohen në nivele të ndryshme).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me konkluzionin nr. 3 të Projekt Raportit, theksojmë se ky është një konkluzion i dalë nga gjetja nr. 3 e Projekt Raportit e cila gjithashtu është bazuar në Raportin e Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese fq. 33. Nga analiza e grupit të auditimit për disa prej qëllimeve dhe indikatorëve rezultoi se politikat dhe strategjitë e hartuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ishin të harmonizuar/përthyer qartësisht me listën e kornizës së indikatorëve globale. Gjithashtu, për një pjesë tjetër rezultoi se nga këto dy ministri nuk ishin të përcaktuar indikatorët e përmendur në gjetjet nr. 4 dhe 5. Mungesa e harmonizimit dhe përcaktimit të qartë referuar listës së indikatorëve globale vështirëson dhe pamundëson monitorimin, ndjekjen dhe arritjen e OZHQ nga ana e këtyre dy ministrive.

Rekomandime

3.1 Kryeministria në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës të marrin masa të rrisin nivelin e harmonizimit dhe përafrimit të qëllimeve dhe indikatorëve gjatë përpilimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030, krahasuar me SKZHI 2015-2020.

Prill 2023

4.1 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa të përditësojë politikat/strategjitë me qëllim harmonizimin jo vetëm të indikatorëve 3.5.2, 3.7.2, 3.9.1 dhe 3.9.2 por dhe të indikatorëve të tjerë të cilët nuk janë të përcaktuar dhe harmonizuar qartë me listën e kornizës së indikatorëve globale.

Në vazhdimësi

5.1 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të përditësojë politikat/strategjitë me qëllim harmonizimin jo vetëm të indikatorëve 12.4.2, 12.5.1 dhe 14.2.1 por dhe të indikatorëve të tjerë të cilët nuk janë të përcaktuar dhe harmonizuar qartë me listën e kornizës së indikatorëve globale.

Në vazhdimësi

4.2 A janë integruar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në një buxhetim të rregullt e të qartë?

“Studime të ndryshme tregojnë se flukset e dobëta financiare dhe kapaciteti i dobët i financimit ishin pengesat kryesore për shumë vende në arritjen e Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, dhe se kjo do të pengojë edhe arritjen e suksesshme të OZHQ-ve.”⁴⁵ Buxheti për OZHQ-të siguron mekanizma për thellimin e integritit vertikal midis aspiratave afatgjata për zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi dhe burimeve mbi të cilat qeveria ka kontrollin më të drejtpërdrejtë, d.m.th buxhetit.⁴⁶ Mbështetur në Urdhrin nr. 63, datë 12.05.2017 të Kryeministrit, i ndryshuar, “Për ngritjen e Komitetit Ndërmintor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm” në shkronjën e) të pikës 5), përcaktohet se: “Komiteti Ndërmintor për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm ka për detyrë të nxisë dhe të sigurojë planifikimin dhe financimet e masave përmes programit buxhetor afatmesëm, si dhe në bashkëpunim me partnerët e zhvillimit, përmes sistemit të planifikimit të integruar (SPI).” Referuar përgjigjeve zyrtare të subjekteve nën auditim, qasja e vendit tonë në implementimin dhe arritjen e OZHQ konsiston në përafrimin e Axsendës 2030 në dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale, ndërsa aktivitetet që duhet të ndërmerren në këtë drejtim janë përfshirë në planet e

⁴⁵ Debapriya Bhattacharya, Toëfiqul Islam Khan, Umme Shefa Rezvana, Lam-ya Mostaque: “Përparimi me OZHQ: Sfidat e implementimit në vendet në zhvillim”, korrik 2016, fq. 15.

⁴⁶ https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxheti për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ-të, fq 9.

veprimet të strategjive. “Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar me VKM Nr. 348, dt.11.5.2016, si edhe dokumentet e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara me VKM, përbëjnë dokumentet e miratuara zyrtarisht e që përthyejnë dhe përfshijnë OZHQ-të.”⁴⁷

Në dokumentet strategjike sektoriale/ndërsektoriale të ministrive të linjës, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, në planet e tyre të veprimit planifikohen buxhete për zbatimin e masave dhe realizimin e objektivave sipas politikave specifike. “Buxhetimi i strategjive sektoriale e ndërsektoriale vijon përmes ciklit të buxhetimit dhe PBA-së, ku vetë institucionet, sipas fushave të përgjegjësisë së tyre, sigurojnë lidhjen midis objektivave /masave të tyre të miratuara në strategjitë sektoriale dhe të harmonizuara me OZHQ-të.”⁴⁸

Pra, me qasjen e zgjedhur nga vendi ynë është synuar që, OZHQ-të të harmonizohen në Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të vendit, objektivat dhe aktivitetet e të cilave janë të buxhetuara në planet e veprimit të strategjive. Buxhetimi i Strategjive e rrjedhimisht edhe i OZHQ-ve që janë harmonizuar në to, vijon me përgatitjen e PBA-ve (ku bëhet lidhja e prioritetëve strategjike me planet buxhetore afatmesme 3-vjecare), e më tej me miratimin e fondeve buxhetore vjetore me anë të ligjeve të buxhetit (ose organeve përgjegjëse për njësit e qeverisjes vendore).

Krahas sa më sipër, në vitin 2019 Shqipëria ka miratuar VKM nr. 248, datë 24.04.2019 “Për Miratimin në Parim, të Marrëveshjes Administrative Standarde për Fondin e Përsheptimit të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Koordinatorit të përhershëm të Kombeve të Bashkuara dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim”. Mbështetur në pikën 1 të nenit 1 të kësaj VKM-je, Donatori (në këtë rast Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë) jep një kontribut deri në gjashtë milionë e pesëqind mijë dollarë amerikane (6,500,000 USD) (këtej e tutje "Kontribute") për të mbështetur Fondin. Llogaria e Fondit administrohet nga Agjenti Administrativ (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e tij përkatëse.

Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, vendi ynë ka ndërmarrë një angazhim total prej 6,653,747 \$ në Fondin e Përsheptimit të arritjes së OZHQ, prej të cilave deri në 31.12.2021 ka depozituar 653,747 \$⁴⁹ (për më tepër strukturën e kontribuesve në këtë Fond e gjeni në Aneksin 4). Deri në fund të vitit 2021, pesë projekte të përbashkëta vazhduan të zbatohen me mbështetjen e Fondit, duke siguruar koherencë, koordinim dhe bashkëpunim të OKB-së në Shqipëri, përfshijnë⁵⁰:

-Mos të lëmë askënd pas (LNB – Leave No one Behind) – Projekti financohet nga Zvicra, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në kuadër të Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (PoCSD) 2017-2021, me pjesëmarrjen e përbashkët të katër agjencive të OKB-së dhe në partneritet të ngushtë me organet qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Qëllimi i projektit – ndryshimi i sistemit për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe pjesëmarrja e personave në nevojë në vendimmarrjen publike – mbështet vizionin e një Shqipërie gjithëpërfshirëse. Kjo, është në përputhje me OZHQ-të dhe me aspiratën e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Projekti zbatohet nën Rezultatin 2: “Përfshirja Sociale”, e më specifikisht Rezultati 2.3 “Përfshirja sociale dhe mbrojtja e PoCSD 2017-2021”. Projekti përfundoi më 31 korrik 2021.

- Fundi i dhunës ndaj grave (EVAW – End Violence Against Woman) në Shqipëri – Projekti financohet nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm. 2017-2021, me pjesëmarrjen e përbashkët të tre agjencive të OKB-së dhe në partneritet të ngushtë me

⁴⁷ Përgjigja e pyetësorit zyrtarë të KLSH, datë 09.09.2022.

⁴⁸ Përgjigja e pyetësorit zyrtarë të KLSH, datë 09.09.2022.

⁴⁹ <https://mptf.undp.org/fund/al100>: Raporti Financiar i Konsoliduar i Fondit të Përsheptimit të OZHQ-ve për Shqipërinë 2021

⁵⁰ <https://mptf.undp.org/fund/al100> : Raporti Vjetor i Progresit i Konsoliduar i Fondit të Përsheptimit të SDG-së për Shqipërinë 2021

organet përkatëse qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Qëllimi i projektit – harmonizimi i legjislationit me normat ndërkombëtare në lidhje me Dhuna Kundër Grave-me Bazë Gjinore (GB-VAW), për të rritur numrin dhe forcimin e mekanizmave institucionale që parandalojnë dhe trajtojnë rastet e GB-VAW dhe për të zhvilluar dhe zbatuar mjete të reja që ndihmojnë në kuptimin dhe parandalimin më të mirë të GB-VAW. Projekti zbatohet nën Rezultatin 2: “Përfshirja Sociale”, Rezultati 2.5: “Dhuna me bazë gjinore e PoCSD 2017-2021”. Projekti ishte planifikuar të mbyllet më 30 qershor 2022.

- *Reagimi ndaj tërmetit* – zbatohet përmes modaliteteve të Shpërndarjes si një mekanizëm, në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021, dhe zbatuar nga agjencitë e OKB-së. Qëllimi i projektit – mbështetja e përpjekjeve të Qeverisë së Shqipërisë për rimëkëmbjen pas tërmetit në fushat e (i) arsimit, (ii) rimëkëmbjes ekonomike dhe elasticitetit, duke përfshirë bujqësinë, (iii) infrastrukturën e komunitetit, (iv) mbrojtjen sociale, (v) mbrojtjen e fëmijëve, dhe (vi) barazia gjinore. Projekti zbatohet nën Rezultatin 4: “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, Rezultati 4.3: “Përgjigja ndaj Tërmeteve” të PoCSD 2017-2021. Projekti është planifikuar të mbyllet deri në fund të 31 dhjetorit 2023.

- *Kontributi i Qeverisë së Norvegjisë* – Projekti financohet nga qeveria e Norvegjisë, dhe zbatohet përmes modaliteteve të Mekanizmit Përmeshje si Një, në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021, dhe zbatohet nga agjencitë e OKB. Qëllimi i projektit - (i) përmirësimi i kushteve të pritjes në kufij dhe sigurimi i monitorimit sistematik të kufijve; (ii) ngritja e kapaciteteve institucionale dhe mbështetja e qeverisë për të përmirësuar aksesin në drejtësi për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara; dhe (iii) menaxhimi efektiv i burimeve natyrore në mbështetje të ekonomisë së gjelbër për një zhvillim të qëndrueshëm të Luginës së Vjosës – Zagori. Iniciativat zbatohen nën Rezultatin 1: “Qeverisja dhe Sundimi i Ligjit”, Rezultati 1.1: “Të drejtat e Njeriut”, Rezultati 1.4: “Qasja në drejtësi” dhe Rezultati 1.6: “Migrimi dhe Azili” dhe Rezultati 4: “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, Rezultati 4.1 “Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Ndryshimet Klimatike dhe Prodhimi Natyror”. Burimet e PoCSD 2017-2021. Projekti përfundoi në mes të prillit 2022.

- *BE-ja për Barazinë Gjinore në Shqipëri* – Zbatimi i acquis të BE-së për Barazinë Gjinore. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021, dhe zbatohet nga agjencitë e OKB-së. Qëllimi i projektit - të përmirësojë transpozimin e acquis të BE-së për Barazinë Gjinore dhe arritjen e rezultateve të barazisë gjinore në përputhje me Axhendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (veçanërisht OZHQ 5). Projekti zbatohet nën Rezultatin 1: “Qeverisja dhe Sundimi i Ligjit”, Rezultati 1.5: “Integrimi i Buxhetit Gjinor dhe Përgjigja Gjinore” të PoCSD 2017-2021. Projekti është planifikuar të mbyllet deri më 31 mars 2023.

Grupi i auditimit kërkoi informacion në MFE mbi Fondin e Përsheptimit të Arritjes së Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshirjen e Shqipërisë në këtë fond, depozitat dhe projektet e financuar prej tij. Në vijim, MFE vuri në dispozicion VKM nr. 248, datë 24.04.2019, “Për miratimin në parim të marrëveshjes administrative standarde për Fondin e përsheptimit të arritjes së Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Koordinatorit të përhershëm të Kombeve të Bashkuara dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim”.

Referuar praktikave të mira, “kur OZHQ-të bëhen pjesë e kuadrit të politikave kombëtare të vendit, është thelbësore që procesi të ndiqet më pas nga integrimi i OZHQ-ve në kornizat buxhetore të vendeve.”⁵¹ Nëse në një shtet, buxhetimi kryhet në bazë të programeve dhe nëse kanë sisteme

⁵¹ https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ-të, fq 2.

gjithëpërfshirëse dhe fleksibël FMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar), integrimi i qëllimeve (targets) të lidhur me OZHQ-të do të ishte shumë më i lehtë.⁵²

Referuar një vlerësimi të kryer nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2021, mbi buxhetin e angazhuar për arritjen e OZHQ-ve në Shqipëri, u konkludua se: “Përafërsisht 17 miliardë dollarë (1 990 miliardë lekë), ose 85% e totalit të shpenzimeve buxhetore midis 2015 dhe 2019 nga burime të brendshme dhe të huaja, kanë kontribuar në arritjen e objektivave të lidhura me OZHQ midis 2015 dhe 2019 në Shqipëri. Drejtuesi kryesor i kostos për strategjinë e përgjithshme të zhvillimit është zhvillimi social dhe kohezioni, i cili zë afërsisht gjysmën e buxhetit total në periudhën 2015-2019. Trajtimi i varfërisë dhe pabarazive kushton rreth 43% të totalit të burimeve publike në Shqipëri; ndërsa një tjetër 21% e shpenzimeve është ndarë për shëndetësinë dhe arsimin gjatë viteve 2015 – 2019.”⁵³ Ashtu sikurse cilësohet edhe në materialin e përgatitur, kjo analizë ka kufizimet e saj.⁵⁴

“...integrimi i sistemeve të informacionit për planifikimin strategjik dhe buxhetimin (AFMIS, IPSIS dhe EAMIS) përfaqëson një mundësi të mirë për të treguar se përafrimi i OZHQ-ve në sistemet e integruara është i realizueshëm me një kosto relativisht të ulët.”⁵⁵

“Nëse Qeveria Shqiptare vendos t'i harmonizojë OZHQ-të jo vetëm me planifikimin e politikave, por edhe me procedurat dhe sistemet e ekzekutimit të politikave (p.sh. ekzekutimi dhe monitorimi i buxhetit), ajo do ta ndihmojë vendin të përmirësojë performancën kombëtare të OZHQ-ve nëpërmjet rritjes së eficiencës të shpenzimeve në fusha të vogla ose linjave buxhetore, duke përmirësuar kështu efektivitetin e shpenzimeve publike drejt qëllimeve (targets) afatgjatë të OZHQ-ve.”⁵⁶

Një nga problematikat që ngre ky raport është: “vihet re në veçanti diskutimin për shkakun e mospërputhjes së PBA-së me strategjitë sektoriale: A ndodh kjo për shkak të kostimit të strategjive në mënyrë jo realiste, apo lidhet me vendimin për të përfshirë në PBA politika të paparashikuara në SKZHI?”⁵⁷

AFMIS (Albanian Financial Management Information System), Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar- është një sistem web, që synohet të integrojë funksionet e ekzekutimit të buxhetit të mbështetur nga Sistemi ekzistues i Thesarit Shqiptar me module funksionale shtesë për të mbështetur përgatitjen e buxhetit, duke përfshirë Planifikimin Afatmesëm të Buxhetit, Menaxhimin e Investimeve Publike, dhe nevojat përkatëse të monitorimit dhe raportimit.⁵⁸ AFMIS duhet të përfshijë gjithashtu një numër ndërfaqesh me IPSIS për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe publikimin në internet.⁵⁹

IPSIS (Integrated Planning Systems information system), Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar - IPSIS synohet të ofrojë funksione të tilla si: Përgatitja e SKZHI-së, strategjive sektoriale dhe strategjive ndërsektoriale; Një proces konsultimi ndërinstitutional për planifikimin strategjik; Monitorimi i SKZHI-së, strategjive sektoriale dhe strategjive ndërsektoriale duke përdorur metodologjinë e Monitorimit të Vlerësimit të Performancës, etj.⁶⁰

⁵² https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ, fq 10.

⁵³ https://albania.un.org/sites/default/files/2021-06/UN%202021_SDG%20Spending%20Albania_Final.docx.pdf Analiza buxhetore e shpenzimeve të lidhura me OZHQ-ve në Shqipëri: 2015 – 2019, Mars 2021, fq 6.

⁵⁴ https://albania.un.org/sites/default/files/2021-06/UN%202021_SDG%20Spending%20Albania_Final.docx.pdf Analiza buxhetore e shpenzimeve të lidhura me SDG në Shqipëri: 2015 – 2019, Mars 2021, fq.74.

⁵⁵ https://albania.un.org/sites/default/files/2021-06/UN%202021_SDG%20Spending%20Albania_Final.docx.pdf Analiza buxhetore e shpenzimeve të lidhura me OZHQ-ve në Shqipëri: 2015 – 2019, Mars 2021, fq 9.

⁵⁶ https://albania.un.org/sites/default/files/2021-06/UN%202021_SDG%20Spending%20Albania_Final.docx.pdf Analiza buxhetore e shpenzimeve të lidhura me OZHQ në Shqipëri: 2015 – 2019, Mars 2021, fq.10.

⁵⁷ https://albania.un.org/sites/default/files/2021-06/UN%202021_SDG%20Spending%20Albania_Final.docx.pdf Analiza buxhetore e shpenzimeve të lidhura me OZHQ në Shqipëri: 2015 – 2019, Mars 2021,76.

⁵⁸ <https://financa.gov.al/afmis-documents/>

⁵⁹ <https://financa.gov.al/afmis-documents/>

⁶⁰ <https://financa.gov.al/afmis-documents/>

“Në përgjithësi, mund të identifikohen katër kategori të kostos së OZHQ-ve, secila përfaqëson një qasje të veçantë ndaj kostos së OZHQ, ku kostoja e nevojave të financimit të OZHQ është më e gjithanshme dhe në përputhje me strategjinë e përgjithshme të financimit. Këto kategori të ndryshme përdoren për të mbështetur funksione të ndryshme politikash, edhe pse ato janë të ndërlidhura. Ajo që është më e rëndësishme në këtë kontekst është kostimi i OZHQ-ve për sektorin publik, d.m.th., kostimet e burimeve (inputet buxhetore) të lidhura me fusha specifike të OZHQ ose target-ëve, të artikuluar gjatë formulimit të buxhetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për OZHQ-të që janë kryesisht publike në natyrë (p.sh. shëndetësia, arsimi, mjedisi) në krahasim me ato ku mund të mobilizohen investimet private (objektivat e OZHQ-ve të lidhura me TIK-un dhe infrastrukturën dhe shërbimet e tjera) si një komponent kritik i strategjisë së financimit të OZHQ-ve.”⁶¹

“Buxhetimi më i mirë” në kontekstin e Axfordës 2030 nënkupton prezantimin e qartë dhe të matshëm të qëllimeve (targets) të OZHQ në ndarjet dhe raportet buxhetore (dhe në elementë të tjerë të ciklit buxhetor) dhe përdorimin e atyre në vendimmarrjen buxhetore.”⁶²

Referuar Guidës (viti 2020) të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim mbi Buxhetimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, buxhetimi i OZHQ-ve udhëhiqet nga ministri përgjegjës për financat dhe ekonominë.⁶³

Gjetje:

6. Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga subjektet nën auditim, si dhe referuar përgjigjeve zyrtare të subjekteve të audituara konstatohet se, nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë lidhja midis OZHQ-ve dhe/apo target-ëve specifik të OZHQ-ve, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre, përgjatë periudhës nën auditim. Referuar Raportit të Auditimit të Norvegjisë dhe Guidës së Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim mbi Buxhetimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, një buxhetim më i mirë në kontekstin e Agjendës 2030 do të thotë që kjo lidhje duhet të jetë e qartë.

Konkluzion:

5. Një lidhje e qartë midis OZHQ-ve dhe buxheteve të planifikuara/alokuara për arritjen e target-ëve specifik të tyre, do të mundësonte përcaktimin në mënyrë më të saktë të fondeve të shpenzuara dhe nevojat për të ardhmen dhe gjithashtu, do të mundësonte monitorimin dhe raportimin mbi fondet e angazhuara dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë**, ku është shprehur qëndrimi si më poshtë.

Qëndrimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 5 dhe nr 6 të Projekt Raportit, respektivisht:

- “Mungesa e një lidhje plotësisht të qartë midis OZHQ-ve dhe buxheteve të planifikuara dhe alokuara për arritjen e target-ëve specifik të tyre, nuk mundëson konkludimin në mënyrë të saktë mbi fondet e shpenzuara dhe nevojat për të ardhmen”.
- “Mungesa e lidhjes plotësisht të qartë midis indikatorëve të OZHQ-ve me buxhetet e planifikuara dhe alokuara, nuk mundëson monitorimin dhe raportimin në mënyrë të saktë mbi fondet e

⁶¹ https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ, fq 34.

⁶² https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ, fq 7.

⁶³ https://sdgfinance.undp.org/sites/default/files/UNDP%20Budgeting%20for%20the%20SDGs%20-%20Guidebook_Nov%202020.pdf Buxhetimi për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Përafrimi i buxheteve kombëtare me OZHQ.

angazhuara dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësim” janë shprehur mendimet si më poshtë:

“Aktualisht nga MFE, me asistencën e UN dhe agjencive të tij, janë hartuar 2 dokumente në lidhje me implikimet financiare të OZHQ-ve, por sigurimi i lidhjes së plotë të tyre me buxhetet e planifikuara dhe alokuara është një proces mjaft kompleks, pasi edhe vetë OZHQ-të janë mjaft komplekse. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë edhe fakti që OZHQ-të financohen nga shumë burimeve financiare, që shkojnë përtej buxheteve shtetërore. Për këtë qëllim edhe vetë arritja e OZHQ-ve synon gjithëpërfshirjen sipas motos së tyre duke mos lenë askënd pas (leaving no one behind).”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sikurse trajtuar në paragrafët përshkruese të nënpyetjes audituese nr.4.2, grupi i auditimit ka analizuar në mënyrë të plotë dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga subjektet e audituara, e më konkretisht nga Kryeministria dhe MFE. Gjithashtu, grupi i auditimit ka kryer edhe intervista me strukturat përgjegjëse, krahas hulumtimit të praktikave më të mira lidhur me buxhetimin e OZHQ-ve. Duke mbajtur në konsideratë karakterin kompleks të OZHQ-ve, grupi i auditimit nuk ka përcaktuar një afat të mbyllur për zbatimin e rekomandimit të lidhur me këtë konkluzion, por e ka konsideruar këtë, një proces i cili duhet të jetë në vëmendjen e strukturave përgjegjëse në vazhdimësi, për shkak të efekteve pozitive që sjellë. Për sa më sipër, subjekti i audituar nuk paraqet kundërshtim lidhur me konkluzionin dhe rekomandimin e grupit të auditimit.

Rekomandim:

6.1 Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe me ministrinë e tjera të linjës⁶⁴ të mundësojë integrimin e qartë të OZHQ-ve në buxhetet afatmesme dhe vjetore, në linjë me prioritetet strategjike të vendit duke përdorur sistemet AFMIS dhe IPSIS, si dhe të mundësojnë raportimin dhe monitorimin e realizimit të buxhetit me fokus OZHQ-të.

Në vazhdimësi

4.3 A ka qenë efektiv monitorimi, raportimi dhe transparenca lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm?

4.3.1 A ekzistojnë kapacitete institucionale dhe profesionale lidhur me monitorimin vlerësimin dhe raportimin e rezultateve të OZHQ?

Forcimi i kapaciteteve institucionale të të gjithë aktorëve kryesorë të angazhuar, duke përfshirë institucionet monitoruese dhe raportuese është shumë i rëndësishëm sa i përket arritjes dhe zbatimit të OZHQ-ve. Zbatimi i OZHQ-ve kërkon përmirësim të kapaciteteve institucionale jo vetëm në nivelin e pushtetit qendror por edhe në pushtetin vendor, stafin akademik, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit të përfshira në proces. Nga ana e qeverisë shqiptare nevojitet forcimi i kapaciteteve në të gjitha nivelet dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në këtë proces. Për më tepër, procesi kërkon rritje të bashkëpunimit ndërsektorial ndërmjet ministrive, institucioneve dhe organizatave të ndryshme. Në veçanti, procesi i zbatimit të OZHQ-ve kërkon burime dhe mekanizma të përshtatshme për përdorimin e të dhënave dhe indikatorëve kombëtarë për qëllime monitorimi. Forcimi i kapaciteteve statistikore në nivel kombëtar dhe shfrytëzimi i sistemeve të të dhënave është një sfidë e rëndësishme në këtë proces. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme nga qeveria për të forcuar dhe përmirësuar indikatorët (duke rishikuar periodikisht kuadrin ligjor, duke analizuar kontekstin e politikave si dhe duke ngritur e forcuar

⁶⁴ Ministrinë e linjës janë përcaktuar në Urdhrin e Kryeministrit nr 63 datë 12.05.2017

kapacitetet teknike dhe administrative).⁶⁵ Krahas forcimit të kapaciteteve një tjetër aspekt mjaft i rëndësishëm është edhe ngritja e strukturave apo njërive të dedikuara lidhur me monitorimi, ndjekjen dhe raportimin e OZHQ-ve nga ana e institucioneve të cilat kanë përgjegjësi për arritjen e tyre. Kjo gjë theksohet edhe në auditimet ndërkombëtare si rasti i Norvegjisë dhe ai i Kanadasë por edhe në GUID 5202 *Sustainable Development: The Role of Supreme Audit Institutions* i cili jep edhe instrumenta mbi çështje të auditimit që kanë të bëjnë me strukturat përgjegjëse për arritjen e OZHQ-ve, kapacitetet e tyre, ekspertizën etj.

Sa i përket situatës aktuale nga përgjigjet zyrtare të sjella nga subjektet rezultojnë se në ministritë e linjës është përcaktuar një person si pikë kontakti për koordinimin e OZHQ-ve. Ky person përveç se ka marrë dhe merr pjesë në takime apo workshop-e lidhur me OZHQ nuk ka patur asnjë përshtetësi në detyrat e tij të punës që lidhet me OZHQ.

Grupi i auditimit gjatë realizimit të auditimit ka përpiluar një sërë pyetjesh lidhur me forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të cilat ju drejtuan të gjithë subjekteve nën auditim. Nga mbledhja dhe përpunimi i përgjigjeve të subjekteve nga grupi i auditimit rezultojnë se janë realizuar trajnime, seminare, workshop-e si me ministritë e linjës të cilat janë përgjegjëse për arritjen e OZHQ-ve ashtu edhe me palët e interesit, shoqëri civile, etj.

Gjithashtu, takimet e ndryshme të koordinuara nga Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes, në kuadër të OZHQ-ve, kanë shërbyer gjithashtu për të ndarë informacione, orientime dhe drejtim metodologjik me institucionet, si edhe shpërndarë informacion edhe me aktorët e përfshirë jashtë qeveritarë, duke shërbyer në drejtim edhe rritjes së kapaciteteve të tyre. Aktivitetet që janë koordinuar nga Kryeministria/Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në kuadër të OZHQ-ve, në bashkëpunim me ministritë e linjës, UN dhe palë të tjera të interesit, paraqiten si më poshtë:

- Seminari mbi diskutimin e Raportit për harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale, zhvilluar më prill 2017, me pjesëmarrje nga UN, donatorët, shoqëria civile. Workshopi u organizua në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të OKB, me ministritë e linjës dhe INSTAT, me praninë e organizatave të UN, shoqërinë civile, akademikë, grupe të interesit etj. Në seminar u paraqit dhe u konsultua metodologjia e punës së Raportit Bazë të OZHQ-ve, si edhe gjetjeve kryesore të evidentuara për draft raportin, lidhur me OZHQ-të;
- Forum i zhvilluar me partnerët për zhvillim dhe integrim (donatorët) me temë “Shqipëria drejt rrugës së saj të anëtarësimit në BE dhe arritjes së OZHQ-ve”, zhvilluar më korrik 2017, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë (DBE), me pjesëmarrjen e partnerëve për zhvillim. Gjatë forumit u diskutua gjerësisht mbi OZHQ-të dhe harmonizimin e tyre në kuadrin strategjik të vendit. Forumi prezantoi qasjen e Qeverisë në Axtendën 2030, si dhe konsistoi në diskutimin e hapave që duhet të ndërmerren për integrimin evropian të vendit dhe identifikimin e sinergjive ndërmjet integrimit në BE dhe arritjes së SDG;
- Takim i zhvilluar me partnerë për zhvillim, të Sekretariatit Teknik të Donatorëve, për konsultimin e Raportit Vullnetar për Shqipërinë për 2018, në qershor 2018;
- Gjashtë takime teknike me ministritë e linjës, institucionet qendrore, INSTAT dhe me pjesëmarrje (sipas rastit) të Zyrës së Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së në Shqipëri apo organizatave OKB, përgjatë periudhës janar-qershor 2018, për përgatitjen e Raportit Vullnetar për Shqipërinë për 2018;
- Takim konsultativ në kuadër të përgatitjes dhe diskutimeve mbi Raportin Kombëtar Vullnetar me organizatat e shoqërisë civile anëtarë të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), akademikë, biznesin, etj., zhvilluar në maj 2018;
- Takim teknik me ministritë e linjës, institucionet qendrore, në kuadër të diskutimeve teknike për treguesit dhe synimet e kuadrit OZHQ në dokumentet strategjike sektoriale, zhvilluar nëntor 2019;

⁶⁵ Voluntary National Review on Sustainable Development Goals, fq 35.

- Seminari me përfshirje të gjerë (donatorët, shoqëria civile, akademikët) i organizuar në bashkëpunim me OECD, në kuadër të diskutimit për Raportit Afatmesëm të Progresit të SKZHI 2015-2020, si edhe punës përgatitore dhe diskutimeve për hartimin e Vizionit 2030 në SKZHI, i zhvilluar në shkurt 2020;
- Takim konsultues i organizuar në bashkëpunim me ministrinë të linjës, institucionet qendrorë, në kuadër të hartimit të Kuadrit të bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm midis Qeverisë Shqiptare dhe OKB-së 2022-2026, i zhvilluar më janar 2021;
- Takim konsultues i organizuar në bashkëpunim me ministrinë e linjës, me pjesëmarrje të gjerë (donatorët, shoqëria civile) në kuadër të hartimit të Kuadrit të bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm 2022-2026 midis Qeverisë Shqiptare dhe OKB-së, i zhvilluar më janar 2021.⁶⁶

Gjetje

7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kanë përcaktuar një pikë kontakti për koordinimin e OZHQ-ve, por ato nuk kanë një njësi apo strukturë të dedikuar në organikën e tyre të brendshme lidhur me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e OZHQ-ve. Përcaktimi i këtij personi nuk është shoqëruar me përshtime të qarta të rolit, detyrës dhe përgjegjësi që ky person do të ketë, por është konceptuar thjesht si personi që do të marrë pjesë në takime periodike që lidhen me OZHQ. Përcaktimi i një njësie apo strukture të dedikuar referuar praktikave të mira me përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara qartë do ta bënte më efektiv llogaridhënien dhe raportimin lidhur me OZHQ.
8. Nga ana e Departamentit të Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri si dhe organizmave të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë (ASP, UN), pavarësisht zhvillimit të shumë trajnimeve seminareve dhe *workshop*-eve rezulton se stafi dhe punonjësit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka përfutur trajnime të lidhura direkt me OZHQ.

Konkluzione

6. Mungesa e një strukture apo njësie me detyra të qarta lidhur me OZHQ-të ndikon negativisht në monitorimin dhe arritje në OZHQ-ve. Përcaktimi i një personi të vetëm pa detyra të qarta lidhur me monitorimin, ndjekjen dhe raportimin ndaj OZHQ-ve sjell mangësi në arritjen e tyre. Duke sjellë në vëmendje edhe qarkullimin e shpeshtë të stafit, shpesh ndodh që lista e personave të caktuar për koordinimin e OZHQ-ve në ministrinë e linjës mos të përditësohet duke qenë në listë persona që nuk janë më pjesë e këtyre ministrive siç ka ndodhur edhe në rastin e MTM për shembull.
7. Trajnimi dhe pjesëmarrja e të gjitha niveleve të stafit të ministrive të linjës dhe veçanërisht MTM, MFE dhe MSHMS është shumë i rëndësishëm për këto institucione. Kujtojmë që referuar Raportit të Rishikimit Kombëtar Vullnetar (*Voluntary National Review*), në fig. 3 këto tre institucione janë përgjegjës për zbatimin e 111 targets-eve, ndaj është mëse e domosdoshme që trajnimi në mënyrë të vazhdueshme i stafit të këtyre institucioneve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ***nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë***, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 7 dhe nr. 8 të Projekt Raportit respektivisht:
 -“Mungesa e një strukture apo njësie me detyra të qarta lidhur me OZHQ-të ndikon negativisht në monitorimin dhe arritje në OZHQ-ve. Përcaktimi i një personi të vetëm pa detyra të qarta lidhur me monitorimin, ndjekjen dhe raportimin ndaj OZHQ-ve sjell mangësi në arritjen e tyre. Duke sjellë në

⁶⁶ Përgjigje e pyetësorit nga Kryeministria, e-mail dt. 09.09.2022

vëmendje edhe qarkullimin e shpeshtë të stafit, shpesh ndodh që lista e personave të caktuar për koordinimin e OZHQ-ve në ministritë e linjës mos të përditësohet duke qenë në listë persona që nuk janë më pjesë e këtyre ministrive siç ka ndodhur edhe në rastin e MTM për shembull”.

- “Trajnimi dhe pjesëmarrja e të gjitha niveleve të stafit të ministrive të linjës dhe veçanërisht MTM, MFE dhe MSHMS është shumë i rëndësishëm për këto institucione. Kujtojmë që referuar Raportit të Rishikimit Kombëtar Vullnetar (Voluntary National Review), në fig. 3 këto tre institucione janë përgjegjës për zbatimin e 111 targets-eve, ndaj është mëse e domosdoshme që trajnimi në mënyrë të vazhdueshme i stafit të këtyre institucioneve” janë shprehur mendimet si më poshtë:

Mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore luan një rol mjaft të rëndësishëm për përmbushjen e qëllimeve. Krijimi i SASPAC, i cili tashmë ka përgjegjësinë e programimit strategjik, bazuar në VKM nr.642, datë 29.10.2021, mund të ndikojë në forcimin e procesit të zbatimit të Agjendës 2030 dhe arritjen e OZHQ-ve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i referohet mungesës së një strukture të dedikuar lidhur me OZHQ për të gjithë periudhën nën auditim si dhe mungesën e trajnimeve nga ana e institucioneve përgjegjëse për arritjen dhe zbatimin e OZHQ-ve.

Rekomandime

- 7.1 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim, të marrin masa për caktimin e një njësie/sektori me detyra dhe përgjegjësi për monitorimin, vlerësimin, arritjen dhe raportimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe të marrin masa për trajnimin e stafit.

Në vazhdimësi

4.3.2 A kanë siguruar strukturat e ngritura nga qeveria shqiptare monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të OZHQ?

Nga auditimi dhe përpunimi i përgjigjeve të pyetësorëve për një element shumë të rëndësishëm në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëse janë të ngritura strukturat që garantojnë, efektivitetin e menaxhimit dhe koordinimit ndër-institucional me qëllim monitorimin, ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e tyre si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, referuar Urdhërit nr. 63, datë 12.05.2017 “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve të Kryeministrit, nga Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore të cilat duhet të marrin masa për harmonizimin e OZHQ në kuadrin strategjik të vendit. Kështu:

- Sipas pikës 5, gërma c të këtij Urdhëri, Komiteti Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve, ka për detyrë të diskutojë raportin fillestar, raportet e ecursisë së arritjes së OZHQ-ve, për vendin e masat zbatuese si dhe të japë dakordësinë për paraqitjen e tyre në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS); Ndërsa sipas pikës 9 të po këtij Urdhëri përcaktohet se Komiteti Ndërmnistror siguron raportimin dhe përcjelljen e çështjeve të lidhura me arritjen e OZHQ-ve dhe të masave të tjera zbatuese në takimet e Komitetit të Planifikimit Strategjik, në përputhje me agjendat përkatëse, në takimin vjetor mbi OZHQ-të në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

Në këto kushte konstatohet se janë realizuar:

Mbledhja e parë e Komitetit Ndërmnistror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axsendës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm u zhvillua në datën 17.05.2017. Kjo mbledhje konstitui dhe formalizoi mbledhjen e parë në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, date 12/05/2017 "Ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe zbatimin e Axsendës 2030 për Zhvillim të qëndrueshëm" dhe pasqyroj një vështrim të përgjithshëm lidhur me partneritetin & bashkëpunimin e Kombeve të Bashkuara si dhe hapat vijues në kuadër të zbatimit të masave për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Takimi i dytë i Komitetit Ndërministror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm u zhvillua në datën 31.01.2018. Takimi u fokusua në dy çështje të rëndësishme, në kuadër të zbatimit të Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm: 1. Raporti mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese, për Shqipërinë; 2. Prioritetet dhe arritjet specifike të qeverisë, dhe lidhja e tyre me OZHQ-të, në kuadër të Raportimit Kombëtar Vullnetar (RKV), në Forumin Politik të Nivelit të Lartë, New York, korrik 2018.

Takimi i tretë i Komitetit Ndërministror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimit të Axfordës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm u zhvillua në datën 31.01.2018 (takimi i dytë për vitin 2018). Takimi u fokusua në dy çështjet të rëndësishme, në kuadër të zbatimit të Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm: 1. Diskutimin dhe miratimin e dokumentit për Raportin Kombëtar Vullnetar të Shqipërisë për OZHQ-të (RKV) ose VNR (*Voluntary National Review on Sustainable Development Goals*), i cili do të paraqitet në Forumin e Nivelit të Lartë politik, në New York, në korrik 2018; 2. Hartimi i Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Nga përpunimi dhe analizimi i përgjigjeve zyrtare të pyetësorëve të përgatitura nga grupi i auditimit drejtuar subjekteve nën auditim, pasqyrohet se instrumentet e monitorimit janë të njëjtat që përdoren për sistemin kombëtar, të lidhur me monitorimin e dokumenteve strategjike kombëtare, në përputhje me qasjen e Qeverisë kundrejt OZHQ-ve, që lidhet me përdorimin e sistemit kombëtar për Axfordën 2030. Kjo nënkupton përdorimin e proceseve monitoruese të dokumenteve strategjike, si SKZHI dhe strategjitë sektoriale, në funksion njëkohësisht të arritjes së OZHQ-ve. Pra, monitorimi i OZHQ-ve kryhet përmes instrumenteve monitorues për raportimin dhe monitorimin e kuadrit strategjik të vendit (Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit dhe strategjitë sektoriale). Raportimi për OZHQ-të kryhet përmes përmes instrumenteve përkatës të raportimit e monitorimit për kuadrin e plotë strategjik të vendit, duke konsistuar në: 1) raportimin dhe monitorimin e zbatimit të SKZHI-së; 2) raportimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

-Raporti i monitorimit afatmesëm të SKZHI 2020, i përgatitur gjatë vitit 2019, pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura në zbatimin e reformave në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2015-2020 (SKZHI II) gjatë periudhës 2015-2018. Raporti është pjesë e procesit të monitorimit afatmesëm për zbatimin e SKZHI II dhe është koordinuar nga Departamenti për Politika dhe Mirëqeverisje në Kryeministri, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, të cilat kanë paraqitur kontributet përkatëse. Raporti paraqet progresin e bërë në zbatimin e politikave kryesore sektoriale gjatë periudhës raportuese dhe gjithashtu synon të identifikojë sfidat me të cilat përballen institucionet. Raporti bazohet në vlerësimin e treguesve të performancës së SKZHI II dhe në kontributin e marrë nga ministritë e linjës, institucionet qendrore, si dhe agjencitë zbatuese përkatëse.

-Në lidhje me raportimin për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore përgatisin raporte monitorimi periodike, të përvitshëm, për zbatimin e strategjive sektoriale.

-Gjithashtu, Shqipëria prezantoi Raportin Vullnetar Kombëtar (VNR – *Voluntary National Report*) për vitin 2018, i cili u paraqit nga Zv. Kryeministri në Forumin e Nivelit të Lartë Politik/ HPLF (*High Level Political Forum*) në korrik 2018, në New York. Raportimi Kombëtar Vullnetar i Shqipërisë është një dokument i rëndësishëm që nxjerr në pah progresin që Shqipëria ka bërë në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për periudhën 2015–2017, në lidhje me 6 prioritetet e Qeverisë, 5 prioritetet e Integritit Evropian, 2 reforma prioritare, si edhe në lidhje me prioritetin e OKB “*Leaving no one behind*” “Të mos lëmë askënd pas”.

Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore kanë raportuar për Axfordën 2030 në Komitetin Ndërministror për arritjen e OZHQ-ve, gjatë përgatitjes së Raportit Vullnetar për Shqipërinë me

kontributet përkatëse, në vitin 2018, në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar në Komitet. Gjithashtu, ministritë e linjës dhe institucionet kanë bashkëpunuar dhe kanë dhënë kontribut për përgatitjen e Raportit Afatmesëm të SKZHI 2020, gjatë procesit të kryer në vitin 2019.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është hartuar dhe miratuar “Plani Shqiptar i Veprimit për Promocionin e Shëndetit 2022-2030” i cili do të monitorohet përmes një grupi treguesish bazë në vitin 2020 dhe objektivat për 2026 dhe 2030. Objektivat dhe treguesit janë përafëruar me OZHQ-të në Axhendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 dhe deklaratat e OBSH-së mbi promocionin e shëndetit, si dhe me Strategjinë e Re Kombëtare Shqiptare për Shëndetin 2021-2030; Planin e Veprimit të SJT 2021-2030; Planin e Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2022-2030 dhe strategjitë dhe angazhimet e tjera kombëtare ekzistuese.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është angazhuar për të hartuar një udhëzues me instruksione që do të shpjegojnë se si do të matet secili tregues. Të dhënat do të mblidhen nga institucionet kombëtare përgjegjëse për aktivitete të veçanta; nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare; vlerësimet e standardizuara, dhe studimet e politikave dhe programeve, si dhe burimeve të tjera. Vlerat fillestare dhe objektivat për treguesit janë përcaktuar për vitin 2020. Një rishikim afatmesëm i këtij Plani Veprimi do të përgatitet në 2026, dhe një raport përfundimtar do të përgatitet për Organet Drejtuese në 2031.

INSTAT ka krijuar platformën e OZHQ-ve për Shqipërinë, i cili tregon të dhëna me informacion për 17 OZHQ-të përkatëse, si dhe referencë për objektivat përkatës dhe treguesit globalë. Në faqen zyrtare të saj⁶⁷, aksesohen të dhënat e publikuara, të cilat përditësohen periodikisht nga INSTAT. Në ministritë e linjës është përcaktuar një person si pikë kontakti për koordinimin e OZHQ-ve.

Nga përgjigjet zyrtare të ardhura nga Kryeministria, theksohet bashkëpunimi i saj me ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të OKB në Shqipëri, ka koordinuar dokumente mbi progresin e bërë për OZHQ-të në Shqipëri, që janë publikuar dhe online si më poshtë vijon:

- ✓ Raporti mbi harmonizimin e Objektiveve të zhvillimit të qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese (*Albania, Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with existing Sectoral Policies*)⁶⁸.
- ✓ Raporti Kombëtar Vullnetar i Shqipërisë 2018 (*Voluntary National Review on Sustainable Development Goals*)⁶⁹.

Raporti shërbeu, për të përgatitur terrenin për Raportin Vullnetar Kombëtar (VNR) për OZHQ-të për vitin 2018.

Për sa më sipër, prioritetet e përcaktuara nga qeveria shqiptare në SKZHI 2015-2020, së bashku me prioritetet e lidhura me Integrimin Evropian, përcaktojnë edhe politikat prioritare të në kuadër të zbatimit të Axhendës globale 2030 dhe arritjes së OZHQ-ve, për periudhën 2015-2020, të cilat u raportuan në Raportin Vullnetar Kombëtar (VNR) për OZHQ-të, që Shqipëria paraqiti në Forumin e Nivelit të Lartë Politik të OZHQ-ve/ HLPF (High Level Political Forum) 2018. Përmbajtja e Raportit VNR për Shqipërinë 2018, përqendrohet specifikisht në këto çështje:

5 prioritete të procesit të Integritimit Evropian; Reforma në administratën publike, institucione të qëndrueshme dhe një shërbim civil modern, profesional dhe depolitizuar; 2. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve gjyqësore; 3. Zgjerimi i luftës kundër korrupsionit; 4. Zgjerimi i luftës kundër krimit të organizuar; 5. Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut (përfshirë të drejtat pronësore).

6 prioritete të qeverisë, sipas SKZHI 2015-2020: 1. Shërbime publike inovative dhe me në qendër qytetarin; 2. Konsolidimi financiar i sektorit të energjisë; 3. Nxitja e inovacionit dhe konkurrencës- Investimet e Huaja Direkte dhe investimet e brendshme; 4. Menaxhimi i integruar i Ujit; 5. Menaxhimi i integruar i Tokës; 6. Reforma strukturore financiare

⁶⁷ <http://www.instat.gov.al/en/sdgs/>

⁶⁸ <http://www.un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>


⁶⁹ https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf

2 reforma të veçanta: reforma në drejtësi, Rilindja Urbane.

Në këtë raport shtjellohet edhe prioriteti i axhendës së OKB “Leaving no one behind” “Të mos lëmë askënd pas”, duke u fokusuar në dy aspekte të rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie integruese: (i) Fuqizimi i grave; (ii) Përfshirja sociale.

Përsa i përket raportimit periodik në parlament në lidhje me OZHQ-të në Kuvendin e Shqipërisë është ngritur Nënkomisioni Për Zhvillimin e Qëndrueshëm⁷⁰, i cili është pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Në këtë kuadër, nga ana e nënkomisionit “Për zhvillimin e qëndrueshëm” është kërkuar nga qeveria që të raportohet nga institucionet qendrore. Nga ana e Kryeministrit/Departamentit të Politikave dhe Mirëqeverisjes janë përgatitur materialet informuese të nevojshme dhe institucionet qendrore kanë raportuar respektivisht në datën 22.06.2020 dhe raportimin në datën 10.17.2021. Në Indeks të OZHQ dhe “Dashboards”⁷¹, paraqitet rankimi i të gjitha shteteve të cilat kanë miratuar Axhendën 2030 përfshirë edhe Shqipërinë, dhe referuar pyetjes nga grupi i auditimit mbi pikëzimin e arritjeve të OZHQ, dhe cila është struktura përkatëse në Shqipëri që vlerëson arritjet e OZHQ dhe struktura përkatëse që bën raportimin në platformën e mësipërme, Kryeministria nuk është përfshirë në përgatitjen e këtij raporti.

Fig. nr 4. Rankimi i Shqipërisë në nivel global lidhur me performancën e arritjes së OZHQ



Rank	Country	Score
59	Bosnia and Herzegovina	71.73
60	Singapore	71.72
61	Albania	71.63
62	Suriname	71.59
63	Ecuador	71.55
64	Algeria	71.54

Burimi: <https://dashboards.sdgindex.org/rankings>

Shqipëria është një vend anëtar në UNECE/Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE)⁷² dhe struktura përkatëse nga pala shqiptare që bashkëpunon dhe ndërvepron me UNECE (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë) lidhur me raportime dhe përcjellje informacionesh për OZHQ është *Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*, i cili është institucioni qendror që përfaqëson qeverinë shqiptare në OKB dhe organizatat e saj, dhe zhvillon të marrëdhënie me organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe OKB, përmes misionëve të saj jashtë vendit. Rezultojnë disa struktura që bashkëveprojnë dhe ndërveprojnë me UNECE-n lidhur me raportime dhe përcjellje informacionesh për OZHQ, për vetë faktin se fusha e aktiviteteve të UNECE është e gjerë dhe këtu përfshihen shume institucione shtetërore. Për takimet midis palës shqiptare me

⁷⁰ Vendimi i Kuvendit nr.11/2020 për legjislatoren 2017-2021 dhe Vendimi i Kuvendit nr.34/2022 për legjislatoren 2021-2025.

⁷¹ <https://dashboards.sdgindex.org/chapters>

⁷² <https://unece.org/unece-and-sdgs/sdgs-region>

HLPF (Forumi i Nivelit të Lartë Politik mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm), është dhënë kontributi si më poshtë nga MEPJ, e cila koordinon me institucionet qendrore, përfshirë Kryeministrinë, në lidhje me përgatitjen për përfaqësimin e Shqipërisë në HLPF⁷³.

Shqipëria ka marrë pjesë në HLPF, në vitin 2015 si anëtare e ECOSOC (Këshilli për Çështjet Ekonomike e Sociale), përmes Misionit të Shqipërisë në OKB. Në vitin 2016 Shqipëria ka marrë pjesë dhe është përfaqësuar nga Zv. Kryeministri. Në vitin 2017 është siguruar pjesëmarrja dhe përfaqësimi nga Misioni i Republikës së Shqipërisë në OKB, në New York. Në vitin 2018, Shqipëria mori pjesë dhe u përfaqësua nga Zv. Kryeministri, i cili ka mbajtur prezantimin e Raportit Vullnetar Kombëtar për vendin. Gjithashtu, Shqipëria ka marrë pjesë në HLPF në vitin 2019 dhe është përfaqësuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Grupi i auditimit konstaton se referuar edhe konkluzioneve të raportit të monitorimit afatmesëm të SKZHI II 2015 – 2020⁷⁴ i cili përfshin një grup prej 50 dokumentesh politikash (duke përfshirë strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale). Një numër kaq i konsiderueshëm i strategjive sektoriale është i dobishëm për të theksuar se të gjitha fushat e mundshme të politikave kontribuojnë dhe ndikohen nga zbatimi i përgjithshëm i SKZHI-së, por në aspektin praktik ajo paraqet të paktën **tre sfida kryesore**:

- ✓ *Së pari, e bën më të vështirë menaxhimin e proceseve të monitorimit dhe raportimit, për shkak të kompleksitetit të dokumenteve të politikave, reformave të ndërlidhura dhe stafit të kufizuar përgjegjës për këto procese.*
- ✓ *Së dyti, synimi për të përfshirë shumicën/të gjitha fushat e politikave nën ombrellën e një strategjie kombëtare si SKZHI, shpesh rezulton të jetë kundër produktive pasi e bën edhe më të vështirë fokusimin në prioritetet kryesore të strategjisë.*
- ✓ *Së treti, Shqipëria ndodhet në një fazë të rëndësishme të procesit të saj të Integrimit Evropian, i cili do të nxiste reformat dhe transformimet në të gjitha fushat e politikave, duke konverguar kështu rezultatet me proceset e tjera në vazhdim.*

Referuar praktikës kanadeze të auditimit të OZHQ-ve është konstatuar se Punësimi dhe Zhvillimi Social në Kanada nuk kishte krijuar një qasje për raportimin vjetor mbi zbatimin e Axhendës 2030 dhe progresin drejt objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Sipas këtij këndvështrimi në një të tretën e rrugës deri në vitin 2030, transparenca dhe raportimi për qytetarët kanadezë mbi progresin është jetik, jo vetëm për të siguruar monitorimin, por edhe për të vazhduar angazhimin e publikut dhe palëve të interesuara në mbarë vendin.⁷⁵

Gjetje

9. Komiteti Ndërmintor për arritjen e OZHQ është mbledhur vetëm 3 herë që nga krijimi i tij dhe konkretisht më datat 17.05.2017, 31.01.2018, 08.06.2018 kur në Urdhërin e Kryeministrit nr. 63, datë 12.5.2017, përcaktohet se ky komitet duhet të mbledhet së paku 2 herë në vit. Kjo situatë riskon procesin e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
10. Komiteti Ndërmintor për arritjen e OZHQ nuk ka përgatitur dhe nuk ka përcjellë çdo vit progres raporte (raporte ecurie) në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS). Në Urdhërin e Kryeministrit nr. 63 theksohet se Komiteti Ndërmintor duhet të përgatisë raportet e ecurisë së arritjes së OZHQ dhe të përcjellë çdo vit çështje të lidhura me arritjet e OZHQ në KPS.
11. Për raportimin periodik në parlament në lidhje me OZHQ-të në Kuvendin e Shqipërisë është ngritur Nënkomisioni Për Zhvillimin e Qëndrueshëm⁷⁶, i cili është pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe ky raportim është kryer dy herë përkatësisht në vitin 2020 dhe në vitin 2021 nga Komiteti Ndërmintor për arritjen e OZHQ. Megjithatë nga auditimi

⁷³ Forumin e Nivelit të Lartë Politik të OZHQ-ve

⁷⁴ SKZHI II 2015 – 2020 Raport Monitorimi Afatmesëm

⁷⁵ Raporti i auditimit të Kanadasë, fq 24.

⁷⁶ Vendimi i Kuvendit nr.11/2020 për legjislaturën 2017-2021 dhe Vendimi i Kuvendit nr.34/2022 për legjislaturën 2021-2025.

konstatohet se nuk është përcaktuar periodiciteti i raportimit të zbatimit të OZHQ-ve në Kuvendin e Shqipërisë.

Konkluzione

8. Zhvillimi i mbledhjeve periodike të Komitetit Ndërmënyror dhe raportimi periodik i implementimit të OZHQ-ve do të mundësonte identifikimin në kohë të hapësirave për përmirësim të arritjes së OZHQ-ve dhe hartimin e një metodologjie për monitorimin e raportim periodik të tyre me afate të mirë përcaktuara për çdo institucion që do implementojë këto objektiva.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **nga Kryeministria është paraqitur observacioni me shkresë nr. 590/9 prot. datë 21.12.2022 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Z. E. A., me pozicion Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë**, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit lidhur me konkluzionin nr. 9 dhe nr. 10 të Projekt Raportit respektivisht:
-“Mos zhvillimi i mbledhjeve periodike të Komitetit Ndërmënyror, përmban riskun e mos identifikimit në kohë të hapësirave për përmirësim të arritjes së OZHQ-ve”;
-“Mos përcaktimi i periodicitetit të raportimit të implementimit të OZHQ-ve, e bën të vështirë arritjen e OZHQ-ve në rang ndërinstytucional për shkak të mos hartimit të një metodologjie për monitorimin dhe raportimin periodik të tyre me afate të mirë përcaktuara për çdo institucion që do implementojë këto objektiva” janë shprehur mendimet si më poshtë:

Periodha e izolimit për shkak të pandemisë së COVID-19, shoqëruar me vështirësi dhe sfida të tjera gjatë kësaj periudhe, si dhe sulmi kibernetik i kohëve të fundit kanë sjellë vështirësi edhe në përmbushjen e detyrave periodike, kjo për shkak edhe të ndërhyrjeve prioritare në përgjigje të situatave të krijuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konkluzionet e grupit të auditimit bazohen në gjetjet nr. 9-11. Urdhëri i Kryeministrit nr. 63, datë 12.5.2017, “Për ngritjen e Komitetit ndërmënyror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm përcaktohet se ky komitet duhet të mbledhet së paku 2 herë në vit. Po ashtu, në këtë Urdhër theksohet se Komiteti Ndërmënyror duhet të përgatisë raportet e ecurisë së arritjes së OZHQ dhe të përcjellë çdo vit çështje të lidhura me arritjet e OZHQ në KPS, raporte këto të cilat nuk janë përgatitur.

Rekomandime

- 9.1 Komiteti Ndërmënyror të marrë masa për t’u mbledhur periodikisht për çështjet që kanë të bëjnë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm e për të përgatitur e përcjellë çdo vit progres raporte (raporte ecurie) në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe publikimin e tyre.

Në vazhdimësi

- 10.1 Komiteti Ndërmënyror në bashkëpunim me Nënkomisionin Për Zhvillimin e Qëndrueshëm i cili është pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvend të marrin masa për përcaktimin e një kriteri të qartë sa i përket periodicitetit të raportimit të Komitetit Ndërmënyror në Kuvend.

Qershor 2023

5. PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” ka si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e strukturave të ngritura për monitorimin, zbatimin, ndjekjen dhe raportimin e bërë kundrejt progresit të OZHQ. Në këtë auditim nuk jemi fokusuar në zbatimin apo arritjen e objektivave të veçantë të OZHQ-ve, por janë parë në tërësi masat që janë marrë për ngritjen e strukturave dhe

kapaciteteve të cilat duhet të zbatojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Subjektet kryesore që janë përzgjedhur në këtë auditim janë Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Periudha e auditimit është 2017-2021.

Nga ana e qeverisë shqiptare edhe pse është hartuar dhe miratuar SKZHI 2015-2020, duke patur në konsideratë nivelin e ulët të harmonizimit të politikave sektoriale kombëtare me OZHQ-të, atëherë risku për të arritur dhe zbatuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm rritet dhe më shumë. Një tjetër dokument që nuk është gjeneruar është edhe Udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Raporti “Integrimi i OZHQ nëpërmjet SKZHI” dhe “Raporti i Harmonizimit të OZHQ me politikat sektoriale ekzistuese” përveç se nuk e justifikojnë mungesën e Udhërrëfyesit nuk udhëzojnë institucionet përgjegjëse për arritjen e OZHQ për mënyrën se si ato duhet të monitorojnë, vlerësojnë, ndjekin dhe raportojnë mbi OZHQ. Të dy këto raporte vlerësojnë respektivisht integrimin, harmonizimin dhe përthyerjen e politikave ekzistuese me OZHQ dhe japin rekomandime dhe orientime se si politikat ekzistuese të integrohen dhe harmonizohen më shumë me OZHQ. I gjithë kuadri i politikave ekzistuese të vendit tonë nuk mundëson harmonizimin e plotë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, çka e vështirëson punën e institucioneve përgjegjëse për monitorimin, ndjekjen, arritjen dhe raportimin e tyre lidhur me OZHQ. Nga analiza e grupit të auditimit për disa prej qëllimeve dhe indikatorëve rezultoi se politikat dhe strategjitë e hartuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ishin të harmonizuara/përthyer qartësisht me listën e kornizës së indikatorëve globalë. Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga subjektet nën auditim, si dhe referuar përgjigjeve zyrtare të subjekteve të audituara, nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë lidhja midis OZHQ-ve dhe/apo target-ëve specifik të OZHQ-ve, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre, përgjatë periudhës nën auditim. Referuar Raportit të Auditimit të Norvegjisë dhe Guidës së Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim mbi Buxhetimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, një buxhetim më i mirë në kontekstin e Axsendës 2030 do të thotë që kjo lidhje të jetë më e qartë. Ministrinë e linjës edhe pse kanë përcaktuar një pikë kontakti për koordinimin e OZHQ-ve, ato nuk kanë një njësi apo strukturë të dedikuar në organikën e tyre të brendshme lidhur me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e OZHQ-ve. Përcaktimi i këtij personi nuk është shoqëruar me përshkrime të qarta të rolit, detyrës dhe përgjegjësi që ky person do të ketë, por është konceptuar thjesht si personi që do të marrë pjesë në takime periodike që lidhen me OZHQ. Përcaktimi i një njësie apo strukture të dedikuar referuar praktikave të mira me përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara qartë do ta bënte më efektiv llogaridhënien dhe raportimin lidhur me OZHQ. Komiteti Ndërmnistror i cili është mbledhur vetëm 3 herë që nga krijimi i tij lidhur me arritjen e OZHQ nuk ka përgatitur dhe nuk ka përcjellë çdo vit progres raporte (raporte ecurie) në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS). Në Urdhrin e Kryeministrit nr. 63 theksohet se Komiteti Ndërmnistror duhet të përgatisë raportet e ecurisë së arritjes së OZHQ dhe të përcjellë çdo vit çështje të lidhura me arritjet e OZHQ në KPS. Për të gjitha gjetjet e gjeneruara në këtë auditim, janë gjeneruar rekomandime me qëllim përmirësimin e situatës lidhur me monitorimin, ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e OZHQ-ve.

6. GRUPI I PUNËS

1. A. G., *Përgjegjës Grupi*;
2. M. K., *Anëtare*;
3. J. Z., *Anëtare*;
4. D. M., *Anëtar*.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. Z.

ANEKSI 1 – Përkufizimi i 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.1	Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.2	Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.3	Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.4	Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.5	Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.6	Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.7	Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.8	Promovimi i rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.9	Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.10	Reduktimi i pabarazisë brenda për brenda vendeve dhe rreth tyre.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.11	Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të sigurt, rezistues dhe të qëndrueshëm.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.12	Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.13	Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e saj.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.14	Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.15	Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirëzimit, ndalimi i degradimit të tokës dhe kthimi në gjendjen e mëparshme si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.16	Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, garantimi i drejtësisë për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.
Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.17	Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe rigjallërimi i Partneritetit botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Aneksi 2: Të dhënat e indikatorëve të përafruar nga MSHMS kundrejt indikatorëve globalë

Akhenda 2030			Në nivel kombëtar					
Nr. OZHQ	Target	Indikatorët	Objektivi kombëtar	Referenca	Target	Referenca	Indikator	Referenca
3. Garantimi i jetës së shëndetshme për çdo qenie njerëzore dhe promovimi i mirëqenies për çdo moshë	3.2 Deri në vitin 2030 t'i jepet fund vdekjeve të parandalueshme të porsalindurve dhe fëmijëve në 5 vjeç nga të gjitha shtetet që kanë si qëllim të reduktojnë vdekjet foshnjore të paktën nën 12 jetë për 1000 lindje, dhe për fëmijët nën 5 vjeç të paktën nën 25 jetë për 1000 lindje, reduktimin e hepatitit, sëmundjet e shkaktuara nga uji dhe sëmundjet e tjera ngjitëse	3.2.1 Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç	Përmirësimi I shëndetit të nënës dhe fëmijës, adoleshentëve si dhe shëndetit seksual dhe riprodhues	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030	Ulja e vdekshmërisë feminare deri në moshën 5 vjeç 6/1000 lindje deri në vitin 2030	Plani I Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022 - 2030, fq 61		
		3.2.2 Shkalla e vdekshmërisë foshnjore	Përmirësimi I shëndetit të nënës dhe fëmijës, adoleshentëve si dhe shëndetit seksual dhe riprodhues	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030	Ulja e vdekshmërisë foshnjore në 3.7/1000 lindje deri në 2030	Plani i Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022 - 2030, fq 61		
	3.3 Deri në vitin 2030, t'i jepet fund epidemive të SIDA-s, tuberkulozit, malarisë dhe sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe luftimi i hepatitit, sëmundjeve të transmetueshme nga uji dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse	3.3.2 Incidenca e tuberkulozit për 1000 banorë	Fuqizimi i politikave, procedurave dhe kapaciteteve për të parandaluar epidemitë, pandemitë dhe emergjencat	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030	Ti jepet fund TB	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 122	Incidenca e TB	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 122
		3.3.3 Incidenca e malarisë për 1000 banorë			Zero malarie			
		3.3.4 Incidenca e hepatitit B për 100,000 banorë			Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të survejancës sentinel për HIV/IST/Hepatitit viral në popullatën kyç (meshkuj që kryejnë seks me meshkuj, punonjësit e seksit, të burgosurit) me një partneritet të strukturave qeveritare me shoqërinë civile dhe partnerë të tjerë	Strategjia e HIV - AIDS 2020 - 2025 (fq 53)	Sistemi i Survejancës së Qëndrueshme të Rojtarit për HIV/IST, i krijuar deri në fund të vitit 2021 dhe plotësisht funksional deri në fund të vitit 2022	Strategjia e HIV - AIDS 2020 - 2025
	3.4 Deri në vitin 2030, të reduktohet me një të tretën vdekshmëria e parakohshme nga sëmundjet jo të transmetueshme përmes parandalimit dhe trajtimit dhe promovimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies	3.4.1 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet sëmundjeve kardiovaskulare, kancer, diabeti ose sëmundje kronike të frymëmarrjes	Promovimi i jetës së shëndetshme dhe garantimi i një mjedisi të shëndetshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndër - sektorial.	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030	ulja e vdekshmërisë së parakohshme me 25% deri në vitin 2030	Programi Kombëtar I Sëmundjeve jo të transmetueshme 2021 - 2030 fq. 22	Ndërrmarja e ndërhyrjeve të integruara për faktorët e rrezikut dhe determinantët e tyre kryesorë në të gjithë sektorët dhe forcimi i sistemit shëndetësor për përmirësimin e parandalimit dhe kontrollit të SJT-ve	

	3.4.2 Shkalla e vdekshmërisë nga vetëvrasjet	Përmirësimi i programeve mbështetëse socio - shëndetësore (integruese) të shëndetit mendor, si dhe burimeve dhe kapaciteteve për zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjet për çrregullimin mendor	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030, fq. 113	Fuqizohen shërbimet e trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Hartohen politika, programe të qëndrueshme. Ngrihen kapacitetet e burimeve njerëzore. Përmirësohet aksesimi në shërbime të shëndetit mendor. Integrohet shërbimi në kujdes parësor. Ngrihen 6 qendra komunitare të shëndetit mendor.	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030, fq. 113	Ulja me 10% e prevalencës së depresionit tek burrat dhe gratë. 100% e popullatës që vuajnë nga depresioni madhor vizitohen tek mjeku	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030, fq. 113
3.5 Të forcohet parandalimi dhe trajtimi i abuzimit me substancat, duke përfshirë abuzimin me drogat narkotike dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit	3.5.1 Trajtimi (farmaceutik, fiziologjik dhe rehabilitimi) për përdoruesit e substancave narkotike	Promovimi I jetës së shëndetshme dhe garantimi I një mjedisi të shëndetshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndër - sektorial.	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030, Aneksi 1 Matrica e Planit të Veprimit fq. 108	7% e popullatës shqiptare ka përdorur gjatë jetës kanabis (2030)	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq.108	11% e popullatës shqiptare ka përdorur gjatë jetës kanabis (2014)	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030
	3.5.2 Përdorimi i dëmshëm i alkoolit, i përcaktuar sipas kontekstit kombëtar si konsumi i alkoolit për frymë (të moshës 15 vjeç e lart) “brenda një viti kalendarik në litra alkool të pastër	Promovimi I jetës së shëndetshme dhe garantimi I një mjedisi të shëndetshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndër - sektorial.	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030, Aneksi 1 Matrica e Planit të Veprimit fq. 108	15% e adoleshentëve kanë qenë të dehur të paktën njëherë në jetë (2030)	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 108	Prevalanca e konsumit të rrezikshëm të alkoolit	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030
3.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet akses universal në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar, informacionin dhe edukimin, dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare	3.7.1 Përqindja e grave të moshës riprodhuese (mosha 15-49 vjeç) që kanë nevojën e tyre për planifikim familjar të plotësuar me metoda moderne.	Të sigurohet që të gjithë njerëzit mund të gëzojnë standardin më të lartë të shëndetit dhe mirëqenies seksuale dhe riprodhuese	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030	Reduktimi i nevojave të paplotësuara për kontracepsion	Plani I Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022 - 2030 fq 64	• Prevalenca e përdorimit të metodave kontraceptive të rritet deri në 15%. • Përqindja e personelit të kujdesit shëndetësor parësor (mami, infermiere dhe/ose mjek familjeje) të trajnuar në edukimin në vazhdim (përfshirë platforma online si: platforma ViC, në lidhje me këshillimin për planifikimin familjar 100%. • Njohuritë mbi metodat kontraceptive në popullatë të jenë >98%. • Nevojat e paplotësuara për planifikim familjar të mos jenë më shumë se 6%.	

	3.7.2 Shkalla e lindjes së adoleshentëve (mosha 10-14 vjeç; mosha 15-19 vjeç) për 1000 gra në atë grupmoshë		SDGs INSTAT				
3.8 Arritja e mbulimit universal shëndetësor, duke përfshirë mbrojtjen e rrezikut financiar, aksesin në shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor thelbësor dhe aksesin në barna dhe vaksina thelbësore të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë	3.8.1 Mbulimi i shërbimeve thelbësore shëndetësore (përcaktuar si mbulimi mesatar i shërbimeve thelbësore bazuar në ndërhyrjet gjurmuese që përfshijnë shëndetin riprodhues, të nënës, të porsalindurit dhe fëmijës, sëmundjet infektive, sëmundjet jo të transmetueshme dhe kapacitetin dhe aksesin e shërbimit, midis popullatës së përgjithshme dhe më të pa favorizuar)	Sigurimi I përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të popullatës nëpërmjet qeverisjes, zhvillimit të politikave, transparencës dhe llogaridhënies	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 118	Sigurohet integrimi i kujdesit shëndetësor ndaj pacientit/Miratoheh mekanizma që garantojnë financim të qëndrueshëm afatgjatë të programeve shëndetësore. Sigurohet qëndrueshmëria e financimit të kujdesit shëndetësor së bashku me reduktimin e vështirësive financiare të përdoruesve të shërbimeve shëndetësore. Krijimi i dhe zbatimi i stimujve financiar për koordinimin e kujdesit/Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe efikasiteti i ofrimit të shërbimeve së bashku me rritjen e autonomisë së ofruesve. Mekanizmat e pagesës në bazë të performancës	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 118	12% e buxhetit të Qeverisë për financimin e shëndetësisë	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 118
	3.8.2 Numri i njerëzve të mbuluar nga sigurimet shëndetësore ose nga një sistem shëndetësor publik për 1000 banorë	Rishikimi dhe zhvillimi I financimit të kujdesit shëndetësor	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 118	Nën 35% e shpenzimeve të përgjithshme nga xhepi	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030 fq. 118	Shpenzimet nga xhepi (OOPS) si % e Shpenzimeve aktuale të Shëndetësisë (CHE).	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030
3.9Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatat e rrezikshme dhe ndotja e ajrit, ujit dhe tokës	3.9.1 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit në familje dhe ambient	Minimizimi I ndotjes së ajrit ambiental dhe ndotjes së mjediseve të brendshme	Plan Veprimi Mjedisor 2020-2024	Monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit ambiental kryesisht në hotspot-e dhe atij të brendshëm. Sistem survejance mbi sëmundshmërinë që lidhet me ekspozimet ndaj ndotjes së cilësisë së ajrit	Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030		Plan Veprimi Mjedisor 2020-2024, Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë 2021 - 2030
	3.9.2Shkalla e vdekshmërisë që i						

		atribuohet ushqimit të pasigurt, kanalizimeve të pasigurta dhe mungesës së higjienës (ekspozimi ndaj ujit të pasigurt, kanalizimeve dhe higjienës për të gjithë (shërbimet ëASH)						
		3.9.3 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet helmimit të paqëllimshëm			Zero vdekshmëri			

Aneksi 3: Të dhënat e indikatorëve të përafshirë nga MTM kundrejt indikatorëve globalë

Axe 2030		Në nivel kombëtar							
Nr. OZHQ	Target	Indikatorët	Objektivi kombëtar	Ref.	Target	Ref.	Indikator	Ref.	Referenca për realizimin*
12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit	12.4 Deri në vitin 2020, të arrihet një menaxhim i shëndoshë mjedisor i kimikateve dhe të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre jetësor, në përputhje me kornizat ndërkombëtare të dakordësuara, dhe të reduktohet ndjeshëm çlirimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, në mënyrë që të minimizohen ndikimet e tyre negative në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.	12.4.1 Numri i palëve në marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore shumëpalëshe për mbetjet e rrezikshme dhe kimikatat e tjera që përmbushin angazhimet dhe detyrimet e tyre në transmetimin e informacionit siç kërkohet nga çdo marrëveshje përkatëse							
		12.4.2 Mbetjet e rrezikshme të krijuara për frymë dhe përqindja e mbetjeve të rrezikshme të trajtuara, sipas llojit të trajtimit							
	12.5 Deri në vitin 2030, reduktimi i ndjeshëm i prodhimit të mbetjeve përmes parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit	12.5.1 Shkalla kombëtare e riciklimit, tonelata materiale të ricikluara							
	13.2 Integroni masat e ndryshimit të klimës në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar	13.2.1 Numri i vendeve që kanë komunikuar krijimin ose funksionimin e një politike/strategjie/plani të integruar që rrit aftësinë e tyre për t'u përshtatur me ndikimet negative të ndryshimeve klimatike dhe për të nxitur qëndrueshmërinë klimatike dhe zhvillimin e emetimeve të ulëta të gazeve serrë në një mënyrë që nuk kërcënon ushqimin prodhimin (përfshirë një plan kombëtar përshtatjeje, kontribut të përcaktuar në nivel kombëtar, komunikim kombëtar, raport përditësues dyvjeçar ose të tjera)							
	14.1 Deri në vitin 2025, parandaloni dhe reduktoni ndjeshëm ndotjen detare të të gjitha llojeve, veçanërisht nga aktivitetet në tokë, duke përfshirë mbeturinat detare dhe ndotjen me lëndë ushqyese	14.1.1 Indeksi i eutrofikimit bregdetar dhe dendësia e mbeturinave plastike lundruese	Minimizimin e elementeve kimik të cilët shkaktojnë eutrofikimin e liqeneve dhe lumenjve si dhe uljen e dendësisë së mbetjeve të plastikës në trupat ujor	RGJM 2021					
14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm	14.2 Deri në vitin 2020, menaxhoni dhe mbronin në mënyrë të qëndrueshme ekosistemet detare dhe bregdetare për të shmangur	14.2.1 Përqindja e zonave kombëtare ekskluzive ekonomike të menaxhuara duke përdorur qasje të bazuara në ekosistem							

	ndikimet negative të rëndësishme, duke përfshirë forcimin e qëndrueshmërisë së tyre dhe të ndërmerrni veprime për restaurimin e tyre në mënyrë që të arrihen oqeanë të shëndetshëm dhe produktiv.								
Goal 15. Mbrori, rivendosni dhe promovoni përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhoni në mënyrë të qëndrueshme pyjet, luftoni shkretëtirëzimin dhe ndaloni dhe ktheni degradimin e tokës dhe ndaloni humbjen e biodiversitetit	15.1 Deri në vitin 2020, të sigurojë ruajtjen, restaurimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore dhe të brendshme të ujërave të ëmbla dhe shërbimeve të tyre, në veçanti pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare	15.1.1 Sipërfaqja pyjore në raport me sipërfaqen totale të tokës	Deri ne vitin 2030 të rritet me 7000 ha	DPPP 2019-2030	0.66%	DPPP 2019-2030	Rritja e sipërfaqes pyjore	DPPP 2019-2030	Raporti I Inventarit Kombëtar te Pyjeve 2022
		15.1.2 Përqindja e vendeve të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që mbulohen nga zonat e mbrojtura, sipas llojit të ekosistemit	Deri ne vitin 2030 të rritet me 25% zonat e mbrojtura	Konventa e SBD					
	15.2 Deri në vitin 2020, promovoni zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve, ndaloni shpyllëzimin, rivendosni pyjet e degraduara dhe rritni ndjeshëm pyllëzimin dhe ripyllëzimin në nivel global.	15.2.1 Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve	Të mbulohet 100% me plane mbarështimi fondi pyjor kombëtar	DPPP 2019-2030	100%	DPPP 2019-2030	mbarështim i pyjeve mbi baza teknike	DPPP 2019-2030	Plane mbarështimi te hartuara per 9 bashki deri ne vitin 2021
	15.3 Deri në vitin 2030, luftoni shkretëtirëzimin, rivendosni tokën dhe tokën e degraduar, duke përfshirë tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmytjet, dhe të përpiqeni të arrini një botë neutrale ndaj degradimit të tokës	15.3.1 Përqindja e tokës që është e degraduar mbi sipërfaqen totale të tokës							
	15.4 Deri në vitin 2030, të sigurojë ruajtjen e ekosistemeve malore, duke përfshirë biodiversitetin e tyre, në mënyrë që të rritet kapaciteti i tyre për të ofruar përfitime që janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm	15.4.1 Mbulimi nga zonat e mbrojtura të vendeve të rëndësishme për biodiversitetin malor	Deri ne vitin 2030 të rritet me 30% zonat e mbrojtura (sipas Kuadrit Global te Biodiversitetit). Kjo do të saktësohet me përditësimin e dokumentit te politikave strategjike te biodiversitetit post 2020	Konventa e Diversitetit Biologjik (CBD)					
		15.4.2 Indeksi i Mbulesës së Gjellbër malore	NA						
	15.5 Të ndërmerren veprime urgjente dhe domethënëse për të reduktuar degradimin e habitateve natyrore, për të ndaluar humbjen e biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, për të mbrojtur dhe	15.5.1 Indeksi i Listës së Kuqe	Përditësimi dhe miratimi i listës se kuqe						

	parandaluar zhdukjen e specieve të kërcënuara							
	15.7 Merrni masa urgjente për t'i dhënë fund gjuetisë dhe trafikimit të llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës dhe adresoni kërkesën dhe ofertën e produkteve të paligjshme të kafshëve të egra	15.7.1 Përqindja e kafshëve të egra të tregtuara që u gjuajt pa leje ose u trafikua në mënyrë të paligjshme	Nuk kemi raste të trafikimit të pa ligjshëm të faunës se egër					
	15.8 Deri në vitin 2020, futni masa për të parandaluar futjen dhe reduktuar ndjeshëm ndikimin e specieve aliene pushtuese në ekosistemet tokësore dhe ujore dhe kontrolloni ose zhdukni speciet prioritare	15.8.1 Përqindja e vendeve që miratojnë legjislacionin përkatës kombëtar dhe burimet e duhura për parandalimin ose kontrollin e specieve të huaja pushtuese	Nuk kemi të dhëna					
	15.9 Deri në vitin 2020, integroni vlerat e ekosistemit dhe biodiversitetit në planifikimin kombëtar dhe lokal, proceset e zhvillimit, strategjitë dhe llogaritë e reduktimit të varfërisë	15.9.1 Progresi drejt objektivave kombëtare të vendosura në përputhje me objektivin e Aichi 2 të Biodiversitetit sipas Planit Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020	• Përditësimi i kuadrit ligjor kombëtar me dispozitat për zbatimin e Protokollit të Nagojës "Për aksesin në burimet gjenetike dhe shpërndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre". • Përcaktimi i procedurave për aplikimin dhe miratimin e dokumenteve PIC (pëlqimi paraprak i informuar) dhe MAT (kushte të dakorduara reciprokisht). • Ndarje e qartë e përgjegjësisë ndërmjet organeve përgjegjëse për zbatimin e Protokollit të Nagoya në vend. • Përmirësimi i sistemit të monitorimit të përdorimit të burimeve gjenetike në vend. • Ndikimi kryesor i drejtpërdrejtë mjedisor është rritja e diversitetit biologjik në Republikën e Shqipërisë dhe përmirësimi i cilësisë së burimeve gjenetike lokale. Politika mund të ketë edhe disa ndikime të tërthorta mjedisore, duke përfshirë këtu: krijimin e mundësive për zhvillimin e marrëveshjeve dypalëshe për përdorimin e burimeve specifike gjenetike lokale bimore ose shtazore si një ndikim indirekt social duke rritur mundësinë e përdorimit të potencialeve të burimeve gjenetike lokale dhe për rrjedhojë, rritja e të ardhurave nga përdorimi i këtyre burimeve gjenetike lokale.					

Aneksi 4: Donatorët e Fondit të Përshejtimt të Arritjes së OZHQ-ve

Donatorët	Angazhimet totale	Depozitat e viteve të mëparshme që	Depozitat e vitit aktual Janar-Dhjetor	Totali i Depozitave
Qeveria e Shqipërisë	6,653,747	653,747	-	653,747
Qeveria e Austrisë	1,214,737	1,214,737	-	1,214,737
Shpërndarja e rezultateve së bashku	3,116,750	3,116,750	-	3,116,750
Qeveria e Danimarkës	2,361,647	2,361,647	-	2,361,647
Bashkimi European	3,913,688	3,474,781	438,907	3,913,688
Dritarja e zgjeruar e financimit DaO	3,825,000	3,825,000	-	3,825,000
Qeveria e Finlandës	735,014	735,014	-	735,014
Qeveria e Holandës	7,090,218	7,090,218	-	7,090,218
Qeveria e Norvegjisë	4,717,336	4,717,336	-	4,717,336
Qeveria e Polonisë	3,296,176	3,296,176	-	3,296,176
Qeveria e Rumanisë	45,266	-	45,266	45,266
Qeveria e Spanjës	4,000,000	4,000,000	-	4,000,000
Sida	14,558,055	14,094,869	463,185	14,558,055
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim	13,249,011	13,249,011	-	13,249,011
Qeveria e Zvicrës	461,553	461,553	-	461,553
Tjetër - Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	1,360,700	-	1,360,700	1,360,700
Totali	70,598,898	62,290,839	2,308,059	64,598,898